



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

VENDIM

Nr. 118, Datë 29.07.2022

**PËR MIRATIMIN E PROCES VERBALIT TË MBLEDHJES TË DATES 30.06.2022
TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës 30.06.2022, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

VENDOSI

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 30.06.2022 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erjon NEXHIPI



PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATË 30.06.2022

Kryesuesi i mbledhjes është kryetari i Këshillit z.Erjon Nexhipi

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 23

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej 23 këshilltarësh.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë z.Sotiraq Filo dhe drejtorë të ekzekutivit

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 3

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: E quajmë mbledhjen e hapur. Nga këshilltarët ka diçka në lidhje me rendin e ditës?

Këshilltar Sh.Kajmaku: Unë mendoj që pikën 3 dhe 4 ti bashkojmë dhe pikën 14 dhe 15 sepse më duken të njëjta.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mirë si rend dite ky është, thjesht trajtimi propozohet që të bashkohen. Në lidhje me rendin e ditës ka një kërkesë nga ekzekutivi për të përfshirë një material që ju është shpërndarë paraprakisht nga shoqëria anonime Tregu i shitjes me shumicë të fruta-perimeve "Për fillimin e procedurave për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë i Fruta Perime" Sh.A dhe caktimin e ekspertëve". Propozohet të shtohet, edhe në fund mund ta lemë, pika 20. Tjetër në lidhje me rendin e ditës ka diçka për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E PROÇESVERBALEVE TË MBLEDHJES SË DATËS 28-PRILL 2022 DHE TË DATËS 23-MAJ 2022 (me e-mail)

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka nga këshilltarët diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës dhe 4 e rendit të ditës

**MBI VËRTETIMIN DHE DHËNIEN E MANDATIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT
Z. KRISTAQ JANI VASILI DHE ZNJ. OLTA LUAN ZYLYFTARI.**

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar Gj.Kristo: Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pas ndarjes nga jeta në mënyrë të parakohëshme të këshilltarit Kristaq Premti, sekretari i këshillit të qarkut ka njoftuar Komisionin Qëndror i Zgjedhjeve, i cili pas verifikimit të të gjithë dokumentacionit me shkrësë dërguar Bashkisë Korçë propozon plotësimin e vakancës së krijuar, duke vijuar me kandidatin e listës shumë emërore të Partisë Demokratia Sociale Z. Kristaq Jani Vasili. Është pika 3, po vijoj dhe me pikën 4.

Pika 4 sërisht kemi të bëjmë me vëndin vakant pas dorëheqjes së këshilltarit Andon Shkodrani nga Këshilli Bashkiak Korçë, e njëjta procedurë nga ana e sekretarit të këshillit bashkiak Korçë, është njoftuar Komisionin Qëndror i Zgjedhjeve pas verifikimit të të gjithë dokumentacionit me shkrësë përcjellë nga Komisionin Qëndror i Zgjedhjeve propozohet plotësimin e vakancës së krijuar me kandidatin e listës shumë emërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë Znj. Olta Luan Zylyftari. Të dyja rastet janë të ngjashme pra plotësim vakancash. I propozojmë Këshillit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Votojmë për pikën 3.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Votojmë dhe për pikën 4 , pastaj bëjmë procedurën e betimit për të dy këshilltarët.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ju lutem këshilltarët e rinj çohemi në këmbë. Akti i Betimit i mbajtur sot më datë 30.06.2022 në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 neni 50 pika 1, në lidhje me betimin e këshilltarit Kristaq Jani Vasili dhe këshilltarit Olta Luan Zylyftari.

Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve.Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë Korçë dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre.

Këshilltare O.Zylyftari: Betohem.

Këshilltar K.Vasili: Beto hem.

Pika 5 e rendit të ditës

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 – 31 MAJ 2022

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: (Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj. Irena Nikaj.

Këshilltare I.Nikaj: Propozoj miratimin e ndihmës ekonomike në relacionin e paraqitur nga Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtor i Kujdesit Social Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe MFK. Për muajin Maj, janë 50 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme” konkretisht për ato familje të cilat kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet romë dhe egjiptiane, sipas kriterëve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 5 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr.4 për kriteret e 6%, datë 27.01.2022. Për muajin Maj 2022, është në dispozicion fondi prej 237.850 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, nga sistemi i pikëzimit. Nga ky fond, përfitojnë 50 familje, të përzgjedhura sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën 129.272 lekë. Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 26 familje, në shumën 32.840 lekë. Pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 162,112 lekë. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, sipas kriterëve specifike të miratuara 23 familje, me fond prej 65.494 lekë specifikuar si persona të vetmuar, persona me pamundësi fizike për të punuar, kryefamiljarë gra me fëmijë të mitur në ngarkim, kryefamiljarë mbi moshë punë, familje të komunitetit rom dhe egjiptian me probleme dokumentacioni. I propozojmë Këshillit miratim të kësaj pike mbështetur në gjithçka është paraqitur në relacion.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 6 e rendit të ditës

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi:(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj.

Këshilltari I.Nikaj:Propozohet ngritja e Komisionit të Strehimit me përbërjen:

- Kryetar i Komisionit,Zv.Kryetar i Bashkisë Korçë
- Anëtar,Drejtorja e Financave
- Anëtar,kryetarët e Rajoneve Administrative ku aktualisht banojnë familjetqë përfitojnë strehim.
- Anëtar ,Drejtor i Drejtorisë së Strehimit Social dhe MBSQ
- Anëtar,Drejtorja Juridike
- Anëtar ,përfaqësues te komunitetit Rom,Organizata “Disutni Albania”
- Anëtar ,përfaqësues i komunitetit Egjiptian
- Anëtar ,përfaqësues nga komuniteti të verbërve
- Anëtar,përfaqësues nga shoqata “Gruaja ne Zhvillim”

Ftoj ta miratojmë komisionin e Strehimit me përbërjen e propozuar nga Bashkia Korçë, Drejtorja e Strehimit Social, Menaxhimi i Banesave Sociale.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar? Ekzekutivi ka gjë për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 7 e rendit të ditës

PËR PËRCAKTIMIN E PRIORITETEVE TË INVESTIMEVE PËR VITET 2023-2025.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Përpara se ti jap fjalën komisionit, ja jap fjalën kryetarit të bashkisë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Atëhere në kuadrin e hartimit të buxhetit afatmesëm të bashkisë siç është edhe detyrim ligjor duhet të miratohet nga ana e Këshillit dhe duhet të miratohet nga ana e këshillit edhe projektet e investimeve për këtë projekt që i takon këtij buxheti afatmesëm 3

vjecar, 2023-2025. Nga ana e bashkisë dhe administratës është hartuar kjo listë projektsh që paraqitet sot për miratim. Kryesisht janë bërë disa investime që janë pjesë edhe e planit tëpërgjithshëm të Bashkisë Korçë, pasi është detyrim ligjor , Zhani mund ta shpjegojë më mirë në mënyrë që ato investime që janë parashikuar në planin e përgjithshëm vendor duhet të jenë pjesë e buxhetit afatmesëm, kështu që janë bërë pjesë e këtij dokumenti, ndërkohë që janë edhe disa investime të tjera që janë parashikuar nga ana e bashkisë. Siç mund ta shihni lista është e gjatëështë e ndarë në disa grupe, infrastrukturë rrugore, investime në arsim, shëndetësi, kulturë. Buxheti që duhet për realizimin e këtyre investimeve patjetër qëështë shumë i madh edhe e tejkalon buxhetin edhe të investimeve edhe të1 viti edhe të 3 viteve të bashkisë, por ju e dini që nga kjo listë prioritetesh investimesh ne pastaj përzgjedhim në varësi edhe të buxhetit të investimeve të bashkisë edhe në varësi të angazhimeve apo financimeve nga ana e qeverisë qëndrore, nga ana e Fondit Shqiptar të Zhvillimit apo dhe nga ana e donatorëve të ndryshëm, përzgjedhim projekte të ndryshme sipas fushës të interesit që mund të ketë secili nga këta financues të projekteve. E rëndësishme që kjo listë të jetë shteruese në kuptimin që mos kemi projekte që janë jashtë kësaj liste. Në rast se gjykoni që ka diçka tjetër që duhet përfshirë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Jo kam një pyetje. Për shembull institucionet në varësi të bashkisënë pika c) kemi një termoizolim i bibliotekës "Thimi Mitko". Mos ka ngelur nga ato listat e vjetra kjo.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Një pjesë e këtyre besoj se dhe mund të kenë ngelur nga momenti kur është hartuar plani i përgjithshëm vendor .

Ekzekutivi Zh. Lubonja: S'është ajo. Është biblioteka e fëmijëve.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Thimi Mitkoja është e re. Një pjesë e këtyre besoj se dhe mund të kenë ngelur nga momenti kur është hartuar plani i përgjithshëm vendor.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Do më falësh, kam përshtypjen se shikoj dhe të tjera gjëra. Termoizolimi i bashkisëme vlerë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po çfarëështë për shembull, në qoftë se mund ti reflektojmë. Është godina e bashkisë?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Godina e bashkisë tonë nuk ka termoizolim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kjo që u rikonstruktua dhe nuk ka termoizolim?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Jo nuk ka.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kjo godinë apo godinën tjetër.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Po të dyja .

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Më fal, kjo sa ka që kemi ndërhyrë, as 3-4 vjet.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Në projekt i rikonstruksionit thuhet që nuk kishte termoizolim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po projektin ne e bëmë, nuk e benë komshinjtë.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Nuk e bëmë ne.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ne e miratuam.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Po vlera që na u ofrua nuk e përfshinte termoizolim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po biblioteka e fëmijëve është vendosur? Se kjo është Thimi Mitko, bibliotekën e fëmijëve nuk e shikoj si prioritet.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Po është , pavarësisht se nuk e kemi caktuar si biblioteka e fëmijëve.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po mund ta korrigojmë.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Po do ta korrigojmë

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ajo si e ka ? Thoma Turtulli?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Po Thoma Turtulli.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra këtu duhet korrigjuar kjo, Thoma Turtulli. Unë e kuptoj dhe siç e kemi diskutuar kjo është një listë e përgjithshme për të thjeshtuar dhe shpesh këto procedurat tuaja. Në 3 vjet ne jemi të vetëdijshëm që nuk realizohen këto.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Po në qoftë se ne kemi një informacion që do bëhet një investim duhet patjetër ta kemi në listën e prioriteteve. Prandaj lista është shumë e gjerë, por nuk është e thënë që kjo listë do të realizohet. Është e pamundur të realizohet.

Këshilltar Sh.Kajmaku: Ashtu si e kemi bërë gjithmonë.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Si gjithmonë?

Këshilltar Sh.Kajmaku: Të parashikohet e gjitha dhe deri ku të arrijë. Për kuriozitet, për shëmbull objektet më të vjetra që janë parashikuar, prej sa vitesh janë që ju ka ikur rradha? Kot më shumë për t'u ditur, me përafërsi.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Deri në 10 vjet, që s'kanë mundur të realizohen.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mirë, disa nga këto që janë në rradhët e këtyre pjesëve që u bashkëngjiten bashkisë të qytetit. Kjo listë është më e madhe seç ka qënë, pa diskutim.

Ekzekutivi Zh.Lubonja:Po.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra kemi sistemime asfaltime të rrugëve brënda fshatrave, kemi dhe pastaj midis fshatrave. Se është një vlerë që është goxha e madhe. Rikonstruksioni i rrugëve në njësitë administrative. Këto janë që lidhin fshatra që është 540,000,000 lekë ?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Jo, është rrugë administrative brenda fshatrave.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po se i kemi dhe këtu pastaj, kemi dhe të veçanta. Kemi asfaltim rruga e kopshtit e fshatit Dishnicë, asfaltim rruga e Çobankave në fshatin Dishnicë, për shëmbull rruga e fshatit Shamoll. Barçin e kemi në ndonjë vend këtu?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Barçi ka qënë në planin e përgjithshëm vendor, ne e kemi realizuar. Si punë më vete nuk është.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Çfarë rrugë nuk janë të cilësuar janë në pika 9 që është një pikë e përgjithshme.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Zhani të lutem diskutimi është ky, unë jam shumë dakord me arsyetimin mirëpo nuk kemi specifike për në Dishnicë një rrugë që është të vesh në Postec dhe Barç ti thua që e kemi realizuar, por sot që flasim nuk ka rrugë të vesh në Barç. Ka rrugë siç kanë qënë, por që të hipësh në makinë të vesh në Barç nuk ka.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Atëhere ideja është që e kemi detyrim që duhet ta përfshijmë në listën e investimeve që është pjesë e planit të përgjithshëm vendor siç është. Pra e kemi bërë këtë përfshirje, dhe pastaj për të dhënë dhe ato investimet që mund të mos jenë kështu specifike në këtë listën e investimeve të planit por që duhen bërë kemi shtuar për pjesën e fshatrave pikën 9) që është rikonstruksioni i rrugëve në njësitë administrative që është një vlerë goxha e madhe dhe që i përmban të gjitha këto rrugët e tjera që nuk i kemi të listuara individualisht por që ne dhe kemi ndërhyrë këtë vit edhe do të ndërhyjmë në të ardhmen. Tani specifikisht meqënëse kapët Barçin do të japim një shpjegim. Në Barç janë bërë dy faza të investimit në rrugën kryesore në silikatë po e quaj, rruga hyrëse ne silikatë, ndërkohë që tani kemi për të bërë edhe fazën e tretë që e përmbyll fare këtë rrugë që do të investohet në kuadrin e projektit të ndërhyrjes për ujësjellësin e fshatit Barç. Pra pjesë të projektit të ndërhyrjes të ujësjellësit përveç rjetit të brëndshëm të depove, lidhjes me ujësjellësin e Korçës, kemi vendosur edhe asfaltimin e vazhdimin të kësaj rruge, nga pika ku e kemi lënë deri në pjesën fundore, dhe është gjë që do të ndodhë në harkun e pak javëve. Ndërkohë për pjesën e fshatrave investimi në infrastrukturën rrugore do të jetë prioritet i punës së bashkisë, pasi në rast se me qytetin pjesën brenda unazës pothuaj e kemi mbyllur, vetëm me ndonjë gjë të vogël, tani ndërhyrjen kryesore për qytetin kemi lagjen e fushës së druve, lagjen e re tek fusha e druve që është prioriteti ynë dhe pastaj kemi dhe zonat informale të qytetit por janë pak krahasuar me çfarë kanë qënë vite përpara, sepse në qytet kemi investuar më shumë vite, dhe fshatrat pastaj patjetër që do të jenë prioriteti ynë për pjesën e investimeve në infrastrukturën rrugore.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Shikoj këtë rikonstruksioni i rrugës "Midhi Kostani" është kjo nga terminali deri te banka ?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Po

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Atje kemi realizuar disa ndërhyrje edhe me ndërmarrjen kryesisht me pjesën e trotuareve, pra krahun nga ana e bankës le të themi. E kemi realizuar si ndërhyrje me anën e ndërmarrjes, tani do një ndërhyrje pjesa e trupit të rrugës, pjesa asfaltike, pjesa e kanalizimeve po është e kompletuar

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Infrastruktura e poshtme besoj është në rregull.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pjesa e kanalizimeve po është e kompletuar.

Këshilltari M.Like: Për shëndetësinë, apo rikonstrukcionin e qendrës shëndetësore të Kamenicës ndoshta është planifikuar e re, nuk e di.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Është pika 2 ndërtimi i qendrave të reja shëndetësore. Këtë po themi. Disa qendra shëndetësore që kam dalë që ta kuptosh, plani i përgjithshëm vendor, plani rregullues i bashkisë është bërë në një proces që ka kaluar disa faza. Njëra prej të cilave ka qënë edhe konsultime publike edhe të përgjithshme edhe me grupe interesi dhe disa nga kërkesat kanë dalë nga pjesa e këtyre konsultimeve dhe janë vendosur të specifikuara, jashtë këtyre ne kemi lënë një pikë të përgjithshme dhe ti e di që për qendrën e Kamenicës unë edhe Drejtorisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor se kështu e ka emrin e saktë e kam paraqitur si një prej prioriteteve tona për ndërhyrje, se është fshat i madh dhe realisht do një ndërhyrje. Për qendra shëndetësore në fakt kemi bërë goxha investime vitet e fundit edhe për shkak se ka qënë prioritet i qeverisë, pra një pjesë e tyre janë financuar nga qeveria, por kemi pasur edhe disa bashkëpunime shumë të mira edhe me disa organizata humanitare "Gjysëm hëna e kuqe e Emirateve". Kemi bërë disa qendra shëndetësore në Floq, në Kuç mos gaboj dhe në Barç.

Këshilltari Sh.Kajmaku: Pika 1 dhe 2 që është për investime është i njëjti zë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Si vlerë për kuriozitetin e kemi Zhani? Pra po që se realizohen të gjitha këto sa është vlera?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Edhe vlerat i ka përcaktuar specialistja. Nuk i kemi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Jo thjesht afërsisht, që të kryhen të gjitha këto halle. Ç'rëndësi ka kur do bëhen, kjo është tjetër gjë.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Vërtet mund të mbyllet një pjesë e këtyre halleve por dhe të tjera dalin. Ajo asnjëherë s'mund të quhet e mbyllur

Këshilltari Sh.Kajmaku: Totali s'lëviz vazhdimisht.

Këshilltari I.Nikaj: Shumë gjëra janë për t'u bërë, dhe do të sugjeroja që disa gjëra që mund të bëhen brenda 6 muajve të ishin në një listë që këto do të bëhen. Thelbi i kësaj liste është që shumë gjëra janë për t'u bërë dhe ndoshta mund të ketë efekt pesimist. Unë mendoj për shëmbull

nëse thoni rregullim të rrugëve urbane kjo duhet bërë dhe në një farë mënyre të ndahen në kjo listë në ajo që do të bëhen me domosdo, në ajo që janë pjesë e shpenzimeve publike dhe pastaj të atyre që presin projektet për tu realizuar. Ndoshta mund të ketë sepse krijon efektin që këtu jemi në gjëndje të kontrollojmë situatën në lidhje me ato që kemi bërë dhe do të bëjmë sepse kjo listë duket shumë e gjatë dhe krijon një lloj pesimizmi duke u zgjatur me të. Ne këtu kemi gjëra të cilat mund të bëhen me pak dhe me një lloj ndërhyrje në kohë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po flasim për dy gjëra të ndryshme, domethënë lista që paraqitet për miratim është një listë e përgjithshme e prioriteteve të investimeve për buxhetin afatmesëm 2023-2025. Kjo që kërkon ju është një listë me çfarë ka mundësi të realizojë bashkia në vitin buxhetor që jemi, viti 2022.

Këshilltari I.Nikaj: Jo, unë mund ta bëja dhe ndryshe që në 2023 kjo, në 2024 kjo, 2025 kjo dhe të dilte se çfarë realizohet nga ana e listës, në mënyrë që disa ti heqim nga kjo listë dhe të veme të tjerat me hallet që do na shtohen.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka një lloj klasifikim që kush është emergjenca dhe kush është.

Këshilltari I.Nikaj: Po kështu e kam dhe për ta vazhduar, ne kemi një kërkesë vazhdimisht, ju thatë që do ta bëjmë atë të zonave informale, që e kemi kërkesë të vazhdueshme, e kemi parë se në kushte të mjerueshme janë ata që jetojnë atje. Dhe duhet ta themi zona 1 është kjo që do jetë e para, 2 kjo dhe kështu me rradhë, edhe ajo e fushës së druve që thatë është shumë mirë që ta kemi në prioritet sepse i kemi pasur vazhdimisht kërkesat e qytetarëve.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Atëhere edhe njëherë, lista e tanishme është lista e përgjithshme e prioriteteve të investimeve. Përsa i takon këtyre siç mund të realizohen në vite të caktuara, ne patjetër do të sjellim në këshill një listë më atë çfarë do të realizojmë gjatë këtij viti. Jemi duke pritur edhe një lloj feedback-u edhe nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për çfarë ata do të angazhohen të zhvillojnë për gjatë këtij viti në Bashkinë e Korçës. Kryesisht bëhet fjalë për projektin me infrastrukturë rrugore dhe termoizolim të godinave dhe pastaj në varësi të atyre që do të marrë angazhim Fondi Shqiptar i Zhvillimit që do të ndërhyjë, ne do të sjellim edhe pjesën që do të investohet nga ana e bashkisë. Përsa i takon investimeve në infrastrukturë rrugore, unë e kuptoj dhe bie dakord që të gjithë banorët kanë të drejtë të kërkojnë që rruga para shtëpisë të jetë e asfaltuar edhe me standart si pjesë të tjera të qytetit, por sa kohë që e kemi të pamundur ti bëjmë të gjitha në 1 vit, ne kemi vendosur një rradhë prioritetesh që besoj bën edhe sens. Fillimisht kemi investuar në infrastrukturën brënda unazës të qytetit, pastaj do të kalojmë tek zona e fushës së druve, mbledhjen e kaluar po e mbani mënd kishit këtu banorët e fushës së druve që me të drejtë mendoj unë, thanë përpara se të investoni në zonat informale, investoni tek ne që kemi ndërtuar me lejë dhe kemi respektuar rregullat e shtetit, dhe unë jam shumë dakord me këtë gjë, ata duhet të jenë prioritarë në investimet, kur të dalim matanë unazës së qytetit dhe pastaj vijmë zonat informale. Megjithatë pavarësisht kësaj rradhe që unë mendoj është e llogjikshme, ne kemi vazhduar me ndërhyrjet edhe në vitet e kaluara, edhe në zonën e fushës së druve çdo vit kemi bërë minimalisht nga 1 rrugë, edhe në zonat informale kemi realizuar investimet e para tek Smt-ja, tek therrtorja, tek perimorja, tek parkimet të themi në zonën e



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

VENDIM

Nr. 118, Datë 29.07.2022

**PËR MIRATIMIN E PROCES VERBALIT TË MBLEDHJES TË DATES 30.06.2022
TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË**


Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës 30.06.2022, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

VENDOSI

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 30.06.2022 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erjon NEXHIPI



PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATË 30.06.2022

Kryesuesi i mbledhjes është kryetari i Këshillit z.Erjon Nexhipi

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 23

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej 23 këshilltarësh.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë z.Sotiraq Filo dhe drejtorë të ekzekutivit

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 3

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: E quajmë mbledhjen e hapur. Nga këshilltarët ka diçka në lidhje me rendin e ditës?

Këshilltar Sh.Kajmaku: Unë mendoj që pikën 3 dhe 4 ti bashkojmë dhe pikën 14 dhe 15 sepse më duken të njëjta.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mirë si rend dite ky është, thjesht trajtimi propozohet që të bashkohen. Në lidhje me rendin e ditës ka një kërkesë nga ekzekutivi për të përfshirë një material që ju është shpërndarë paraprakisht nga shoqëria anonime Tregu i shitjes me shumicë të fruta-perimeve "Për fillimin e procedurave për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë i Fruta Perime" Sh.A dhe caktimin e ekspertëve". Propozohet të shtohet, edhe në fund mund ta lemë, pika 20. Tjetër në lidhje me rendin e ditës ka diçka për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E PROÇESVERBALEVE TË MBLEDHJES SË DATËS 28-PRILL 2022 DHE TË DATËS 23-MAJ 2022 (me e-mail)

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka nga këshilltarët diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës dhe 4 e rendit të ditës

MBI VËRTETIMIN DHE DHËNIEN E MANDATIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT

Z. KRISTAQ JANI VASILI DHE ZNJ. OLTA LUAN ZYLYFTARI.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar Gj.Kristo: Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pas ndarjes nga jeta në mënyrë të parakohëshme të këshilltarit Kristaq Premti, sekretari i këshillit të qarkut ka njoftuar Komisionin Qëndror i Zgjedhjeve, i cili pas verifikimit të të gjithë dokumentacionit me shpresë dërguar Bashkisë Korçë propozon plotësimin e vakancës së krijuar, duke vijuar me kandidatin e listës shumë emërore të Partisë Demokratice Sociale Z. Kristaq Jani Vasili. Është pika 3, po vijoj dhe me pikën 4.

Pika 4 sërisht kemi të bëjmë me vëndin vakant pas dorëheqjes së këshilltarit Andon Shkodrani nga Këshilli Bashkiak Korçë, e njëjta procedurë nga ana e sekretarit të këshillit bashkiak Korçë, është njoftuar Komisionin Qëndror i Zgjedhjeve pas verifikimit të të gjithë dokumentacionit me shpresë përcjellë nga Komisionin Qëndror i Zgjedhjeve propozohet plotësimin e vakancës së krijuar me kandidatin e listës shumë emërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë Znj. Olta Luan Zylyftari. Të dyja rastet janë të ngjashme pra plotësim vakancash. I propozojmë Këshillit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Votojmë për pikën 3.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Votojmë dhe për pikën 4 , pastaj bëjmë procedurën e betimit për të dy këshilltarët.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ju lutem këshilltarët e rinj çohemi në këmbë. Akti i Betimit i mbajtur sot më datë 30.06.2022 në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 neni 50 pika 1, në lidhje me betimin e këshilltarit Kristaq Jani Vasili dhe këshilltarit Olta Luan Zylyftari.

Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë Korçë dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre.

Këshilltare O.Zylyftari: Betohem.

Këshilltar K.Vasili: Beto hem.

Pika 5 e rendit të ditës

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE,DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 – 31 MAJ 2022

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: (Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj. Irena Nikaj.

Këshilltare I.Nikaj: Propozoj miratimin e ndihmës ekonomike në relacionin e paraqitur nga Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtor i Kujdesit Social Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe MFK. Për muajin Maj, janë 50 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme” konkretisht për ato familje të cilat kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet rome dhe egjiptiane, sipas kriterëve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 5 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr.4 për kriteret e 6%, datë 27.01.2022. Për muajin Maj 2022, është në dispozicion fondi prej 237.850 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, nga sistemi i pikëzimit. Nga ky fond, përfitojnë 50 familje, të përzgjedhura sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën 129.272 lekë. Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 26 familje, në shumën 32.840 lekë. Pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 162,112 lekë. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, sipas kriterëve specifike të miratuara 23 familje, me fond prej 65.494 lekë specifikuar si persona të vetmuar, persona me pamundësi fizike për të punuar, kryefamiljarë gra me fëmijë të mitur në ngarkim, kryefamiljarë mbi moshë punë, familje të komunitetit rom dhe egjiptian me probleme dokumentacioni. I propozojmë Këshillit miratim të kësaj pike mbështetur në gjithçka është paraqitur në relacion.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 6 e rendit të ditës

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi:(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj.

Këshilltari I.Nikaj:Propozohet ngritja e Komisionit të Strehimit me përbërjen:

- Kryetar i Komisionit,Zv.Kryetar i Bashkisë Korçë
- Anëtar,Drejtorja e Financave
- Anëtar,kryetarët e Rajoneve Administrative ku aktualisht banojnë familjetqë përfitojnë strehim.
- Anëtar ,Drejtor i Drejtorisë së Strehimit Social dhe MBSQ
- Anëtar,Drejtorja Juridike
- Anëtar ,përfaqësues te komunitetit Rom,Oganizata “Disutni Albania”
- Anëtar ,përfaqësues i komunitetit Egjiptian
- Anëtar ,përfaqësues nga komuniteti të verbërve
- Anëtar,përfaqësues nga shoqata “Gruaja ne Zhvillim”

Ftoj ta miratojmë komisionin e Strehimit me përbërjen e propozuar nga Bashkia Korçë, Drejtorja e Strehimit Social, Menaxhimi i Banesave Sociale.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar? Ekzekutivi ka gjë për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 7 e rendit të ditës

PËR PËRCAKTIMIN E PRIORITETEVE TË INVESTIMEVE PËR VITET 2023-2025.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Përpara se ti jap fjalën komisionit, ja jap fjalën kryetarit të bashkisë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Atëhere në kuadrin e hartimit të buxhetit afatmesëm të bashkisë siç është edhe detyrim ligjor duhet të miratohet nga ana e Këshillit dhe duhet të miratohet nga ana e këshillit edhe projektet e investimeve për këtë projekt që i takon këtij buxheti afatmesëm 3

vjecar, 2023-2025. Nga ana e bashkisë dhe administratës është hartuar kjo listë projektesh që paraqitet sot për miratim. Kryesisht janë bërë disa investime që janë pjesë edhe e planit të përgjithshëm të Bashkisë Korçë, pasi është detyrim ligjor, Zhani mund ta shpjegojë më mirë në mënyrë që ato investime që janë parashikuar në planin e përgjithshëm vendor duhet të jenë pjesë e buxhetit afatmesëm, kështu që janë bërë pjesë e këtij dokumenti, ndërkohë që janë edhe disa investime të tjera që janë parashikuar nga ana e bashkisë. Siç mund ta shihni lista është e gjatë është e ndarë në disa grupe, infrastrukturë rrugore, investime në arsim, shëndetësi, kulturë. Buxheti që duhet për realizimin e këtyre investimeve patjetër që është shumë i madh edhe e tejkalon buxhetin edhe të investimeve edhe të 1 viti edhe të 3 viteve të bashkisë, por ju e dini që nga kjo listë prioriteteve investimesh ne pastaj përzgjedhim në varësi edhe të buxhetit të investimeve të bashkisë edhe në varësi të angazhimeve apo financimeve nga ana e qeverisë qëndrore, nga ana e Fondit Shqiptar të Zhvillimit apo dhe nga ana e donatorëve të ndryshëm, përzgjedhim projekte të ndryshme sipas fushës të interesit që mund të ketë secili nga këta financues të projekteve. E rëndësishme që kjo listë të jetë shteruese në kuptimin që mos kemi projekte që janë jashtë kësaj liste. Në rast se gjykoni që ka diçka tjetër që duhet përfshirë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Jo kam një pyetje. Për shembull institucionet në varësi të bashkisë në pika c) kemi një termoizolim i bibliotekës "Thimi Mitko". Mos ka ngelur nga ato listat e vjetra kjo.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Një pjesë e këtyre besoj se dhe mund të kenë ngelur nga momenti kur është hartuar plani i përgjithshëm vendor.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: S'është ajo. Është biblioteka e fëmijëve.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Thimi Mitkoja është e re. Një pjesë e këtyre besoj se dhe mund të kenë ngelur nga momenti kur është hartuar plani i përgjithshëm vendor.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Do më falësh, kam përshtypjen se shikoj dhe të tjera gjëra. Termoizolimi i bashkisëme vlerë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po çfarë është për shembull, në qoftë se mund ti reflektojme. Është godina e bashkisë?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Godina e bashkisë tonë nuk ka termoizolim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kjo që u rikonstruktua dhe nuk ka termoizolim?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Jo nuk ka.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kjo godinë apo godinën tjetër.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Po të dyja.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Më fal, kjo sa ka që kemi ndërhyrë, as 3-4 vjet.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Në projekt i rikonstruksionit thuhet që nuk kishte termoizolim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po projektin ne e bëmë, nuk e benë komshinjtë.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Nuk e bëmë ne.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ne e miratuam.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Po vlera që na u ofrua nuk e përfshinte termoizolim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po biblioteka e fëmijëve është vendosur? Se kjo është Thimi Mitko, bibliotekën e fëmijëve nuk e shikoj si prioritet.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Po është , pavarësisht se nuk e kemi caktuar si biblioteka e fëmijëve.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po mund ta korrigojmë.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Po do ta korrigojmë

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ajo si e ka ? Thoma Turtulli?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Po Thoma Turtulli.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra këtu duhet korrigjuar kjo, Thoma Turtulli. Unë e kuptoj dhe siç e kemi diskutuar kjo është një listë e përgjithshme për të thjeshtuar dhe shpesh këto procedurat tuaja. Në 3 vjet ne jemi të vetëdijshëm që nuk realizohen këto.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Po në qoftë se ne kemi një informacion që do bëhet një investim duhet patjetër ta kemi në listën e prioriteteve. Prandaj lista është shumë e gjerë, por nuk është e thënë që kjo listë do të realizohet. Është e pamundur të realizohet.

Këshilltar Sh.Kajmaku: Ashtu si e kemi bërë gjithmonë.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Si gjithmonë?

Këshilltar Sh.Kajmaku: Të parashikohet e gjitha dhe deri ku të arrijë. Për kuriozitet, për shëmbull objektet më të vjetra që janë parashikuar, prej sa vitesh janë që ju ka ikur rradha? Kot më shumë për t'u ditur, me përfaqësi.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Deri në 10 vjet, që s'kanë mundur të realizohen.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mirë, disa nga këto që janë në rradhët e këtyre pjesëve që u bashkëngjiten bashkisë të qytetit. Kjo listë është më e madhe seç ka qënë, pa diskutim.

Ekzekutivi Zh.Lubonja:Po.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra kemi sistemime asfaltime të rrugëve brënda fshatrave, kemi dhe pastaj midis fshatrave. Se është një vlerë që është goxha e madhe. Rikonstruksioni i rrugëve në njësitë administrative. Këto janë që lidhin fshatra që është 540,000,000 lekë ?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Jo, është rrugë administrative brenda fshatrave.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po se i kemi dhe këtu pastaj, kemi dhe të veçanta. Kemi asfaltim rruga e kopshtit e fshatit Dishnicë, asfaltim rruga e Çobankave në fshatin Dishnicë, për shëmbull rruga e fshatit Shamoll. Barçin e kemi në ndonjë vend këtu?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Barçi ka qënë në planin e përgjithshëm vendor, ne e kemi realizuar. Si punë më vete nuk është.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Çfarë rrugë nuk janë të cilësuara janë në pika 9 që është një pikë e përgjithshme.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Zhani të lutem diskutimi është ky, unë jam shumë dakord me arsyetimin mirëpo nuk kemi specifike për në Dishnicë një rrugë që është të vesh në Postec dhe Barç ti thua që e kemi realizuar, por sot që flasim nuk ka rrugë të vesh në Barç. Ka rrugë siç kanë qënë, por që të hipësh në makinë të vesh në Barç nuk ka.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Atëhere ideja është që e kemi detyrim që duhet ta përfshijmë në listën e investimeve që është pjesë e planit të përgjithshëm vendor siç është. Pra e kemi bërë këtë përfshirje, dhe pastaj për të dhënë dhe ato investimet që mund të mos jenë kështu specifike në këtë listën e investimeve të planit por që duhen bërë kemi shtuar për pjesën e fshatrave pikën 9) që është rikonstruksioni i rrugëve në njësitë administrative që është një vlerë goxha e madhe dhe që i përmban të gjitha këto rrugët e tjera që nuk i kemi të listuara individualisht por që ne dhe kemi ndërhyrë këtë vit edhe do të ndërhyjmë në të ardhmen. Tani specifikisht meqënëse kapët Barçin do të japim një shpjegim. Në Barç janë bërë dy faza të investimit në rrugën kryesore në silikatë po e quaj, rruga hyrëse në silikatë, ndërkohë që tani kemi për të bërë edhe fazën e tretë që e përmbyll fare këtë rrugë që do të investohet në kuadrin e projektit të ndërhyrjes për ujësjellësin e fshatit Barç. Pra pjesë të projektit të ndërhyrjes të ujësjellësit përveç rrjetit të brëndshëm të depove, lidhjes me ujësjellësin e Korçës, kemi vendosur edhe asfaltimin e vazhdimin të kësaj rruge, nga pika ku e kemi lënë deri në pjesën fundore, dhe është gjë që do të ndodhë në harkun e pak javëve. Ndërkohë për pjesën e fshatrave investimi në infrastrukturën rrugore do të jetë prioritet i punës së bashkisë, pasi në rast se me qytetin pjesën brenda unazës pothuaj e kemi mbyllur, vetëm me ndonjë gjë të vogël , tani ndërhyrjen kryesore për qytetin kemi lagjen e fushës së druve, lagjen e re tek fusha e druve që është prioriteti ynë dhe pastaj kemi dhe zonat informale të qytetit por janë pak krahasuar me çfarë kanë qënë vite përpara, sepse në qytet kemi investuar më shumë vite, dhe fshatrat pastaj patjetër që do të jenë prioriteti ynë për pjesën e investimeve në infrastrukturën rrugore.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Shikoj këtë rikonstruksioni i rrugës "Midhi Kostani" është kjo nga terminali deri te banka ?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Po

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Atje kemi realizuar disa ndërhyrje edhe me ndërmarrjen kryesisht me pjesën e trotuareve, pra krahun nga ana e bankës le të themi. E kemi realizuar si ndërhyrje me anën e ndërmarrjes, tani do një ndërhyrje pjesa e trupit të rrugës, pjesa asfaltike, pjesa e kanalizimeve po është e kompletuar

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Infrastruktura e poshtme besoj është në rregull.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pjesa e kanalizimeve po është e kompletuar.

Këshilltari M.Like: Për shëndetësinë, apo rikonstrukcion i qendrës shëndetësore të Kamenicës ndoshta është planifikuar e re, nuk e di.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Është pika 2 ndërtimi i qendrave të reja shëndetësore. Këtë po themi. Disa qendra shëndetësore që kam dalë që ta kuptosh, plani i përgjithshëm vendor, plani rregullues i bashkisë është bërë në një proces që ka kaluar disa faza. Njëra prej të cilave ka qënë edhe konsultime publike edhe të përgjithshme edhe me grupe interesi dhe disa nga kërkesat kanë dalë nga pjesa e këtyre konsultimeve dhe janë vendosur të specifikuara , jashtë këtyre ne kemi lënë një pikë të përgjithshme dhe ti e di që për qendrën e Kamenicës unë edhe Drejtorisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor se kështu e ka emrin e saktë e kam paraqitur si një prej prioriteteve tona për ndërhyrje, se është fshat i madh dhe realisht do një ndërhyrje. Për qendra shëndetësore në fakt kemi bërë goxha investime vitet e fundit edhe për shkak se ka qënë prioritet i qeverisë, pra një pjesë e tyre janë financuar nga qeveria, por kemi pasur edhe disa bashkëpunime shumë të mira edhe me disa organizata humanitare "Gjysëm hëna e kuqe e Emirateve". Kemi bërë disa qendra shëndetësore në Floq, në Kuç mos gaboj dhe në Barç.

Këshilltar Sh.Kajmaku: Pika 1 dhe 2 që është për investime është i njëjti zë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Si vlerë për kuriozitet e kemi Zhani? Pra po qe se realizohen të gjitha këto sa është vlera?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Edhe vlerat i ka përcaktuar specialistja. Nuk i kemi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Jo thjesht afërsisht, që të kryhen të gjitha këto halle. Ç'rëndësi ka kur do bëhen, kjo është tjetër gjë.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Vërtet mund të mbyllen një pjesë e këtyre halleve por dhe të tjera dalin. Ajo asnjëherë s'mund të quhet e mbyllur

Këshilltar Sh.Kajmaku: Totali s'lëviz vazhdimisht.

Këshilltari I.Nikaj: Shumë gjëra janë për t'u bërë, dhe do të sugjeroja që disa gjëra që mund të bëhen brënda 6 muajve të ishin në një listë që këto do të bëhen. Thelbi i kësaj liste është që shumë gjëra janë për t'u bërë dhe ndoshta mund të ketë efekt pesimist. Unë mendoj për shëmbull

nëse thoni rregullim të rrugëve urbane kjo duhet bërë dhe në një farë mënyre të ndahen në kjo listë në ajo që do të bëhen me domosdo, në ajo që janë pjesë e shpenzimeve publike dhe pastaj të atyre që presin projektet për tu realizuar. Ndoshta mund të ketë sepse krijon efektin që këtu jemi në gjëndje të kontrollojmë situatën në lidhje me ato që kemi bërë dhe do të bëjmë sepse kjo listë duket shumë e gjatë dhe krijon një lloj pesimizmi duke u zgjatur me të. Ne këtu kemi gjëra të cilat mund të bëhen me pak dhe me një lloj ndërhyrje në kohë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po flasim për dy gjëra të ndryshme, domethënë lista që paraqitet për miratim është një listë e përgjithshme e prioritetëve të investimeve për buxhetin afatmesëm 2023-2025. Kjo që kërkon ju është një listë me çfarë ka mundësi të realizojë bashkia në vitin buxhetor që jemi, viti 2022.

Këshilltari I.Nikaj: Jo, unë mund ta bëja dhe ndryshe që në 2023 kjo, në 2024 kjo, 2025 kjo dhe të dilte se çfarë realizohet nga ana e listës, në mënyrë që disa ti heqim nga kjo listë dhe të veme të tjerat me hallet që do na shtohen.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka një lloj klasifikim që kush është emergjenca dhe kush është.

Këshilltari I.Nikaj: Po kështu e kam dhe për ta vazhduar, ne kemi një kërkesë vazhdimisht, ju thatë që do ta bëjmë atë të zonave informale, që e kemi kërkesë të vazhdueshme, e kemi parë se në kushte të mjerueshme janë ata që jetojnë atje. Dhe duhet ta themi zona 1 është kjo që do jetë e para, 2 kjo dhe kështu me rradhë, edhe ajo e fushës së druve që thatë është shumë mirë që ta kemi në prioritet sepse i kemi pasur vazhdimisht kërkesat e qytetarëve.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Atëhere edhe njëherë, lista e tanishme është lista e përgjithshme e prioritetëve të investimeve. Përsa i takon këtyre siç mund të realizohen në vite të caktuara, ne patjetër do të sjellim në këshill një listë më atë çfarë do të realizojmë gjatë këtij viti. Jemi duke pritur edhe një lloj feedback-u edhe nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për çfarë ata do të angazhohen të zhvillojnë për gjatë këtij viti në Bashkinë e Korçës. Kryesisht bëhet fjalë për projektin me infrastrukturë rrugore dhe termoizolim të godinave dhe pastaj në varësi të atyre që do të marrë angazhim Fondi Shqiptar i Zhvillimit që do të ndërhyjë, ne do të sjellim edhe pjesën që do të investohet nga ana e bashkisë. Përsa i takon investimeve në infrastrukturë rrugore, unë e kuptoj dhe bie dakord që të gjithë banorët kanë të drejtë të kërkojnë që rruga para shtëpisë të jetë e asfaltuar edhe me standart si pjesë të tjera të qytetit, por sa kohë që e kemi të pamundur ti bëjmë të gjitha në 1 vit, ne kemi vendosur një rradhë prioritetesh që besoj bën edhe sens. Fillimisht kemi investuar në infrastrukturën brënda unazës të qytetit, pastaj do të kalojmë tek zona e fushës së druve, mbledhjen e kaluar po e mbani mënd kishit këtu banorët e fushës së druve që me të drejtë mendoj unë, thanë përpara se të investoni në zonat informale, investoni tek ne që kemi ndërtuar me lejë dhe kemi respektuar rregullat e shtetit, dhe unë jam shumë dakord me këtë gjë, ata duhet të jenë prioritarë në investimet, kur të dalim matanë unazës së qytetit dhe pastaj vijnë zonat informale. Megjithatë pavarësisht kësaj rradhe që unë mendoj është e llogjikshme, ne kemi vazhduar me ndërhyrjet edhe në vitet e kaluara, edhe në zonën e fushës së druve çdo vit kemi bërë minimalisht nga 1 rrugë, edhe në zonat informale kemi realizuar investimet e para tek Smt-ja, tek therrtorja, tek perimorja, tek parkimet të themi në zonën e

tokave të universitetit, pra kemi ndërhyrë në këto zona për t'ju dhënë mesazhin edhe këtyre familjeve që kanë erdhur dhe kanë ndërtuar në zonat informale pa lejë ndërtimi, që nuk do të jetë e largët perspektiva që infrastruktura do ti përafrohet infrastrukturës së qytetit, por si rregull që të respektojmë edhe vullnetin e banorëve për të qënë korrekt me ligjin. Unë mendoj që do jetë njëri nga kriteret, kush ka qënë korrekt me ligjin dhe ka ndërtuar me plan, me lejë, ai duhet të jetë i favorizuar për të marrë investime në infrastrukturë. Kjo është llogjika dhe sinjalet i kemi dhënë në të gjitha drejtimet, kemi ndërhyrë me mundësitë që ka pasur bashkia, dhe do të vazhdojmë edhe këtë vit të investojmë në sa më tepër akse rrugore që të mundemi, edhe në qytet edhe në fshatra. Ndërkohë edhe meqënëse u hap si temë, ku e kemi përqëndruar fokusin tonë për investime, në infrastrukturën publike thashë kemi një listë rrugësh edhe në qytete edhe në fshat, po presim çfarë do marrë angazhim Fondi , për të përcaktuar çfarë do bëjë ndërmarja e shërbimeve publike, çfarë do bëjë edhe bashkia me buxhetin që kemi ne dispozicion. Për pjesën e ndërhyrjeve në objekte arsimore kemi paraqitur 3 objekte, shkollën "Themistokli Gërmenji", gjimnazin nr.3, dhe kopshtin nr.6. Po presim vendimin nga ana e komitetit që ngrihet për këto investimet në arsim, shpresojmë të kemi një projekt fitues.

Ekzekutivi A.Dishnica: Erdhi, është miratuar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ja një lajm i mirë, është miratuar shkolla "Themistokli Gërmenji". Shumë mirë që u miratua, është një nga tre gjimnazet e qytetit, shkollë me emër, shkollë në qëndër, e kishim prioritet, shumë mirë që na paska erdhur. Për pjesën e efijences së energjisë kemi disa projekte që do ti financojmë në pjesën e termoizolimit të pallateve, të banesave private në bashkëpronësi, pasi mendoj që projekti më i rëndësishëm që ka qyteti Korçës për të ardhmen në pjesën e infrastrukturës, është një projekt që do të adresojë çështjen e ngrohjes së qytetit dhe të lidhur me ngrohjen edhe efijencen e energjisë në banesa , pasi këto të dyja janë të lidhura bashkë dhe ne jemi duke punuar edhe në drejtim të një projekti për ngrohjen dhe paralel edhe për të financuar termoizolimimin e godinave private. Besoj do të kemi gjatë këtij viti, një ndërhyrje në bashkëpunim me agjensinë e efijences së energjisë për të termoizoluar 4 objekte dhe në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit do të kemi edhe 8 objekte të tjera ku do të ndërhyet me termoizolim dhe pastaj jemi duke menduar për një skemë e cila vazhdimisht do të gjenerojë fonde që ky projekt i ndërhyrjeve termoizoluse të vazhdojë në kohë dhe ne të kemi mundësinë që në hark kohor X të ndërhyjmë në të gjitha banesat me bashkëpronësi të qytetit të Korçës. Është një nga prioritetet tona, kemi përfunduar fazën e parë të tregut të gjësë së gjallë, që do të vendosë një standart edhe të tregëtimit edhe të sigurisë ushqimore, ndërkohë që lajmi pozitiv është që na është miratuar edhe aplikimi që kemi bërë tek AZHBR-ja , të realizojmë një fazë të dytë atje që ta rritim pak standartin e infrastrukturës në këtë treg, dhe materiali që kemi sjellë shtesë lidhet pikërisht me këtë treg. Do të realizohen disa ndërhyrje, do vazhdojmë të mbyllim pjesën e projekteve me ujësjellsa në fshat, do të fillojmë me disa ndërhyrje në pjesën e kanalizimeve në disa fshatra, ndërkohë që shpresoj të kemi mbështetje dhe financim nga qeveria për të realizuar një projekt që synon adresimin e kanalizimit të ujrave të zeza të shoqëruara me mini impiantet të trajtimit të ujrave të përdorura për të gjitha fshatrat kryesore të fushës të Bashkisë së Korçës, që është një projekt shumë i rëndësishëm në infrastrukturë. Brënda këtij viti do të fillojmë projektin e efijences së energjise së ndriçimit publik që e kemi te financuar nga

qeveria Zviceriane. Kemi një projekt në pjesën e përballimit të emergjencave civile që kemi aplikuar tek agjensia e kombëtare e emergjencave civile, shpresojmë të na financohet. Këto janë pak a shumë projektet që mendojmë të realizojmë gjatë këtij viti, të themi i kemi 90% në vijë, edhe me financimet tona edhe me financimin nga Fondi Shqiptar, edhe me financimin nga qeveria. Tani po presim edhe disa projekte që kemi me donatorë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Shpjegimet për prioritetet e këtij viti ishin të plota, lajm shumë i mirë ishte për shkollën "Themistokli Gërmenji". Unë personalisht të sugjeroj që këtë pjesën e projektit shumë të rëndësishëm në lidhje me termoizolim dhe rritjen e efijencës të banesave kolektive, të jetë në vijën e duhur dhe të shfrytëzohet ky moment dhe për ti disiplinuar me menaxhimin e këtyre ndërtesave, që ka në krijimin e punës bashkëpunimin midis banorëve, në krijimin e strukturave të administrimit të këtyre banesave, sepse unë sidomos për pallatet që janë mbi 30-40 vjet mendoj që në vitet e ardhme dhe jo shumë larg, do të ketë vështirësi në ekzistencën e atyre objekteve, jo më në mirëmbajtje apo termoizolim. Pra të përdoret kjo fazë për të krijuar një praktikë të mirë, për të vendosur disa rregulla që i ka ligji i bashkëpronësisë por po qe se i le në vullnetin e lirë të njerëzve ti zbatojnë apo të mos i zbatojnë, kuptohet që në përgjithësi nuk zbatohet. Ne si institucion kemi përgjegjësinë që të ndikojmë që këto ndërtesa kolektive të administrohen në përputhje me ligjin e bashkëpronësisë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po unë nuk u ndala shumë në ky projekti i ngrohjes së qytetit dhe efijencës së energjisë, në banesat, objektet private kryesisht këto pallatet, pra godinat kolektive me bashkëpronësi pasi kjo meriton goxha shtjellim. Mbase në një mbledhje tjetër kur të kemi dhe konfirmimin e financimit qoftë nga agjensia e efijencës së energjisë, qoftë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, mund ta flasim më gjatë. Patjetër që për sa kohë që fondi do të jetë i kufizuar dhe ne nuk është se do ti bëjmë të gjitha pallatet përnjerësh, por duhet të përzgjedhim midis pallateve, do të vendosim disa kriteret dhe dy nga kriteret kryesore janë: e para ngritja e strukturës menaxhuese të objektit, që është asambleja e bashkëpronarëve të pallatit në caktimin e administratorit që do jetë në gusht dhe e dyta është kontributi i banorëve në realizimin e këtij projekti, pasi konstatoj që ka një lloj keqkuptimi që është detyrimi i bashkisë që të bëjë ndërhyrje për termoizolim apo për mirëmbajtje të këtyre pallateve, ndërkohë që nuk është kështu. Ligjërisht do të duhet që komplet ndërhyrjet, qofshin të mirëmbajtjes qofshin të termoizolimit, do të duhet të realizoheshin 100% nga fondet që duhet të mblidhnin banorët. Po ne duke e ditur sesa e rëndësishme është skema e efijencës së energjisë dhe kjo ndërhyrje dhe duke e kuptuar dhe pamundësinë financiare të realizohet 100% nga ana e banorëve do të bashkë investojmë në një masë goxha të konsiderueshme, por do të duhet edhe banorët të venë një vlerë të caktuar për investimin. Do të jetë një nga kriteret për përzgjedhjen se ku do të ndërhyet. Ndërkohë po mendoj edhe për një skemë ku mund ta diskutojmë më me detaje më vonë që do ti mundësonte bashkisë që çdo vit të kishte një sasi lekësh për këtë qëllim dhe ideja ishte që të kishim mundësi të investonim në një park fotodetajik, në pronësi të bashkisë ku të ardhurat që do të krijonim nga shitja e energjisë të shkojnë një pjesë për të shlyer investimet e parkut dhe pjesa tjetër të shkojë në këtë skemë apo në këtë fond qarkullues që do ti dedikohesh përmirësimit të efijencës së energjisë në godinat kolektive të qytetit të Korçës, pra deri në fund të futnim këto të ardhura, të futnim kontribute nga donatorët, të futnim kontribute nga bashkëpronarët dhe çdo vit të kishim

një fond në dispozicion për të ndërhyrë në një numër të caktuar të objekteve. Kjo është një ide që jemi duke e menduar. Për çështjet e energjisë dhe të efikasitetit të energjisë janë çështje që do jenë shumë sensitive edhe në nivel global, dhe sa më shumë që të merremi dhe të fokusohemi dhe të kemi projekte dhe ide në këto gjëra, do të kemi mundësi të financojmë pasi edhe për shkak të situatës së krijuar, luftës, rritjes së çmimeve të energjisë, paqëndrueshmërisë së tregjeve, besoj se do të ketë shumë financime dhe mundësi në fusha apo projekte që lidhen me energjinë dhe energjinë e rinovueshme me efikasitetin e energjisë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nuk dua që të përsëriten edhe njëherë ato që thamë , vetëm që kjo pjesa e menaxhimit të banesave kolektive duhet të jenë prioritet, kam parasysh disa zona, që ne pavarësisht se ato janë private por kur ndodh problemi kthehet në i përgjithshëm. Padiskutim që, nuk mundet që pjesë e qytetit që kujdeset vetë për shpirtë apo banesat e tyre të përgjigjet dhe për pjesën e qytetit që nuk përkujdesen. Kjo mund të zgjidhet në një formë tjetër siç mund të jenë tarifatat, ose ne që e kemi detyrim ligjor që të krijojmë një ndërmarrje për kujdesjen e banesave kolektive dhe të detyrojmë ata që përfitojnë nga këto shërbime të paguajnë, e kemi detyrim ligjor.

Ekzekutivi A.Dishnica: Ne nuk e kemi detyrim ligjor. Ne kontaktojmë kompani që duhet ta ofrojmë si shërbim. Nuk është detyrimi i bashkisë që të ketë një ndërmarrje për përkujdesjen e banesave .

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Është në gjërat që duhet adresuar.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kur bie një objekt ose kur 15 familje dalin të pastreha është problemi ynë pastaj, nuk është më problemi i tyre. Pra për mua kjo mund të zgjidhet, përveç atyre formave që ju thatë që janë shumë të mira, duhet objektet që përfitojnë të kenë një tarifë ekstra krahasuar me objektet që nuk përfitojnë, se në fund vlera e objektit është rritur, ato familje do të kursejnë, që kanë dobi dhe të përgjithshme sepse po kursehet energjia, por edhe personale sepse po kursejnë ata direkt dhe me këto para do t'ju jepet mundësia për objektet e tjera e kështu me rradhë si zinxhir do vazhdojë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Është një temë që realisht ja vlen të diskutohet dhe do kohë të diskutohet dhe unë do të mirëprisja çfarëdo lloj imputi nga ana e këshilltarëve për këtë gjë, sepse realisht kemi pika që nuk i kemi dhënë dot zgjidhje. Kemi shumë familje që janë larguar dhe shtëpitë i kanë lëshuar me qera, kemi familje që janë në kushte të pamundësisë financiare për ta paguar atë kontributin e përmuajshëm që duhet për të krijuar fondin për mirëmbajtjen e objektit. Duhet të gjejmë një zgjidhje , mbase duhet të mendojmë edhe ndonjë skemë të pagesës me këste fatura e ujit. Puna është që nuk kemi mekanizëm shtrëngues që t'ja mbledhësh në momentin që nuk paguan detyrimin. Ligji mos gaboj flet për vendosjen e barrës hipotekore, por ja e vendose barrën hipotekore, barra ka vlerë vetëm në momentin kur ta shesë, sepse për sa kohë nuk bën transaksion në pronë rrezik as e merr vesh fare kur i është vënë një barrë në hipotekë. Është realisht një gjë që duhet të merremi dhe duhet ndërgjegjësuar që nuk është detyrimi i bashkisë. Ne përpiqemi t'ja u themi si anës e anës që si ata që kanë shtëpi private që e rregullojnë vet

suvanë, tjegullat dhe juve jeni një vllazëri më e madhe me 10 familje ,16 familje dhe duhet të vini lekë të rregulloni gjërat e përbashkëta, tarracën, ullukët, të lyeni shkallën, të ndroni dritat.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mund të përdoret e njëjta ideologji që është përdorur në fshatrat për shembull me ujësjellsit, ku ata pranojnë të bëhen pjesë e skemës së ujësjellsit paguajnë tarifën. Kur duan ta mbajnë vetë s'paguajnë dhe nuk është ndonjë gjë si parim, pavarësisht prapë ne e diskutojmë atë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Është një temë që mirëpresim me shumë dëshirë sugjerime se si mund ta realizojmë zbatimin e ligjit të bashkëpronësisë në administrim të bashkëpronësisë të banesave kolektive .

Këshilltar Sh.Kajmaku: Duhet një studim rreth vlerave që shkoi termoizolim ose duhet të dimë që t'ja u kërkojmë qytetarëve që të paguajnë por duhet të jemi çik koshientë sa është vlera , se po të jetë një vlerë jo shumë e madhe dhe do ta paguajnë, por kur ka vlera të mëdhaja jo të gjithë janë në gjëndje ta paguajnë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Shiko nuk po flasim në asnjë rast për skemë që ata ta bëjnë totalisht vetë, se për atë s'kemi çfarë ofrojmë fare si bashki, ata thjesht mbledhin lekët.

Këshilltar Sh.Kajmaku: Ti thuash qytetarit hajde të bashkëpunojmë duhet të dish sa shkon.

Këshilltare I.Nikaj: Çdo banesë kolektive ka një problem që është mungesë e kujdesit për banesën. Unë mendoj që mund të ketë ndonjë skemë të sigurimit, të mos jenë privat por të jenë publike dhe të ndërtojnë një të tillë, që jo vetëm për të kontribuar por edhe të kenë kujdes sepse këto banesa po shkatërrohen.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Shiko është ligji i bashkëpronësisë për atë po flasim, sepse banorët e këtyre pallateve duhet të kuptojnë që janë në një banesë private me bashkëpronësi, njësoj sikundër unë jam me prindërit tek shpia ime dhe jemi bashkëpronarë, ata janë bashkëpronarë të një ndërtese private, e kanë marrë në çmimet që e kanë marrë në vitin 91-91 kur u bënë privatizimet, tani duhet të mirëmbahen dhe jo të presin çfarë do na bëjë bashkia.

Këshilltare I.Nikaj: Flas për sigurime, që këto familje të investojnë për sigurinë e pasurisë së tyre.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Sigurimin e pronës po thua? Nga zjarri, nga tërmetet nga këto? Si detyron njeri, janë privat të sigurohen.

Këshilltare I.Nikaj: Këtë po them, të gjejmë mënyrën sesi ti bëjmë të futen në skema të tilla sepse fatëkeqësitë natyrore janë të zakonshme.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk ka lidhje me ne. Ajo është një marrëdhënie individuale ndërmjet një pronari privat dhe një kompanie sigurorese.

Këshilltari I.Nikaj: Po bëjmë një banesë kolektive, pastaj ne kemi përgjegjësinë për ti zgjidhur problemet e tyre.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kush ne?

Këshilltari I.Nikaj: Fjala bie si ent publik, si institucion nuk kemi përgjegjësi ?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo, po flasim jo për fatkeqësi të tipit larg qoftë tërmet që është detyrim në bazë të ligjeve që shteti ka , po flasim për dëmtime për shkak të mos mirëmbajtjes.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nuk është se i shpëtojmë përgjegjësisë, asnjëherë nuk i shpëtojmë. Në fund themi gjyna familje në nevojë. Pra ideja, ajo që po thotë zysha si mund të gjejmë një mekanizëm.

Këshilltari I.Nikaj: Një mekanizëm që t'ju vijmë në ndihmë. Sepse shpesh herë mjetet e informimit këtë duan që të shikojnë ku janë problemet dhe të evidentojnë që s'keni marrë masa. Unë mendoj një fond të krijohet dhe të jetë i gatshëm për të ndërhyrë në këto raste.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në rast se bëhet fjalë për sigurinë e banesave nga përmytjet, zjarri, tërmeti. Kjo nuk ka lidhje me mirëmbajtjen rutinë. S'të merr përsipër kompani sigurimesh që të financojë për shkak se ti je siguruar, dëmtimet që vijnë nga mos mirëmbajtja rutinë e objektit. Nuk ka lidhje me këtë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar, veç atij sugjerimit për rregullimin e emrit për listën e prioriteteve ? Mendoj që meritonte këtë kohë për diskutim, mbase edhe më shumë po të ishim në rrethana të tjera që të kishte dhe opozitë, do të ishte mbase diskutim më i gjërë. Nga qytetarët ka diçka për të shtuar për listën e prioriteteve dhe investimeve?

Qytetare Vjollca: I nderuar kryetar i bashkisë, i nderuar kryetar i këshillit. Unë quhem Vjollca Musaka dhe jam banore e lagjes 14 rruga "David Selenica". Sot kam ardhur me shqetësimin më të madh për rrugën tonë. Ne kemi qënë në proces legalizimi dhe e kemi përfunduar këtë proces, quhemi zonë formale. Por shqetësimi jonë është se në qoftë se bie zjarr atje nuk hyn dot as zjarrfiksjat as ambulanca. Ju lutem na ndihmoni. Jemi qytetarë me të drejta të barabarta, paguajmë taksa dhe të gjitha. Nuk jemi as në periferi po jemi afër. Tani për 2-3 muaj fillojnë shirat.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Më fal Vjollca, për punën e prioriteteve që diskutuam.

Qytetare Vjollca: Unë ju kam thënë disa herë dhe kryetarit dhe nën kryetarit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tani diskutimi juaj është që është rruga e ngushtë.

Qytetare Vjollca: Po le të zgjerohet dhe të bëhet më vonë asfaltimi. Vetëm duam zgjerim se nuk hyn dot makina. Jemi shumë të shqetësuar.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mirë ideja është këtu për prioritete dhe investimet, pastaj prapë do ta marrësh fjalën për këtë çështje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Meqënëse u hap si çështje, pra edhe njëherë bëhet fjalë për një studim urbanistik që caktohen rrugët dhe pastaj ndërhyrje nga bashkia për të prishur gardhet dhe për të zgjeruar rrugët, pa kërkuar mundësinë e asfaltimit. Atëhere Zhani sapo më tha që i kemi dërguar një shkresë ASHK-së për të marrë gjëndjen e legalizimeve në këtë lagje. Ka erdhur përgjigjia qëka një listë me objekte që janë legalizuar. Tani Zhani, urbanistika domethënë, drejtoria duhet ta vendosë këtë listë në hartë dhe të shikojë janë legalizuar të gjitha objektet apo ka objekte që nuk janë legalizuar, nuk e ka bërë këtë punë akoma. Pra edhe këtu kemi 2 skenare ka mbaruar legalizimi apo nuk ka mbaruar, po nuk ka mbaruar duhet të presim, nëse ka mbaruar pastaj të bëjmë rjetin rrugor pastaj është dhe ana tjetër që ja u kam shpjeguar kur u takuam në rast se zotërinjtë, juve dhe të tjerët atje, keni legalizuar përveç shpive edhe tokën ku duhet të bëhet rruga kemi përsëri 2 skenarë, juve bini dakord që ta falni një pjesë të kësaj toke për rrugën ku do të kaloni ju dhe jo ne, në këtë rast ndërhyrja bëhet shpejt heqim vijat në rrugë dhe i prishim ose i prishni vetë, mënyra tjetër është që ju apo ata që janë në atë rrugë nuk bien dakord, thonë këtë e kemi marre me legalizim, tani na i shpronëso. Në këtë rast duhet të bëjmë procedurë shpronësimi, që bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave. Duhet lekët për të shpronësuar truallin që keni zënë juve pa leje dhe e keni legalizuar, në rast se ka ndodhur kjo gjë dhe në momentin që do të kemi këto lekë duhet edhe minimalisht nja 6 muaj kohë që të shpronësohet dhe pasi ka mbaruar shpronësimi po mund të ndërhyet për të prishur gardhet dhe për të hapur rrugën. Kjo është si rradhë pune.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pa mbaruar me ata që kanë ndërtuar me leje, nuk vazhdohet me ata që kanë ndërtuar pa leje .

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk po flasim për investime, po flasim vetëm për hapjen e rrugës.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Edhe hapjen e rrugës nuk mund të shpronësojmë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Okay, këtë po them. Meqënëse jeni pak familje dhe ju thashë edhe kur u takuam bashkë , ajo që unë kërkoj sepse është halli juaj , ne jemi në pjesë të formalizuara të qytetit. Ajo që unë kërkoj si ndihmë nga ju është mundësisht bisedoni dhe me ata familjarët e tjerë se pak familje janë dhe ju themi e mira jonë e përbashkët është që këtë rrugën mos e kemi 3 m2 por ta kemi 5-6 m2 , te biem dakord të japim nga 1 m2 nga të dy krahët edhe pastaj bashkia ta bëjë rrugë sepse përndryshe do merremi me historira shpronësimi që duan edhe lekë për t'u shpronësuar, duhet edhe kohë. Të lutem na ndihmoni për këtë gjë, si rradhë është kjo që sapo ju thashë .

Qytetare Vjollca: Unë ju dëgjova kryetar, po për mirëmbajtje tani se ju dërgoni njerëz dhe investigoni , është shumë keq gjëndja nuk dalim dot. Mbushen gropat, është shumë keq gjëndja.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal Vjollca prandaj të pyeta çfarë është kërkesa. Iku e para kjo është kërkesa e dytë është mirëmbajtja, qarkullimi i rrugës ekzistuese? Po mund ta bëjmë.

Ndërkohë ajo që mund të themi për këshilltarët është se në zonën informale të ish kundër ajrorit ne kemi ndërhyrë përpara disa viteve jo tek rruga tuaj por tek rruga " Nexhip Vinçani" mos gaboj dhe kemi bërë asfaltimin e një pjese. Pra kemi ndërhyrë atje ku mund të ndërhyeshe, dhe ishte e kontrolluar pjesa e rrugve. Këtu tek ju, për pjesën e hapjes të rrugës na ndihmoni që ta përshpejtojmë duke marrë dakordësinë e familjeve të tjera e kanë mbaruar se kanë mbaruar procesin e legalizimit, t'ja marrim dakordësinë dhe të ndërhyjmë më shpejt. Në rast se nuk bien dakord është rruga e gjatë, kurse për këtë qarkullimin patjetër mund ta bëjmë mirëmbajtjen.

Këshilltar Sh.Kajmaku: Atje mirë është të vazhdohet procedura dhe nga ana e bashkisë dhe nga qytetarët , të mblidhen sa më parë që të qarkullohet rruga.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Dakord

Këshilltare I.Nikaj: Për rendin e ditës është 2022-2023 . Ka ndonjë problem që këtu është 2023-2025

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Është gabim në rendin e ditës. Duhet 2023-2025.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi:Atëhere pika 7 e rendit të ditës për "Përcaktimin e prioriteteve te investimeve 2023-2025". Komisioni kishte gjë për të shtuar.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 8 e rendit të ditës

MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025. FAZA E PARË.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Të lutem Bona konçize siç di ti, se harxhuam shumë kohë për prioritetet. Prioritetet meritonin të trajtoheshin pak më gjatë.

Ekzekutivi V.Ziko: Atëhere programi buxhetor afatmesëm për vitin 2023-2025 faza e parë, është përgatitur në zbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, të ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimit nr. 23 datë 30.7.2018, si dhe të udhëzimit nr. 8 datë 28.02.2022.

Programi Buxhetor Afatmesëm prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot

e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. PBA për vetë rëndësinë që ka është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disa vjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Duke patur parasysh gjatë procesit të menaxhimit të programeve buxhetore janë hasur vështirësi shumica e bashkive, ku ka pasur rreth 36 programe dhe me udhëzim të Ministrisë së Financave të vitit 2022 është vendosur që nga 36 programe të kalojnë në 20 programe. Bashkia e Korçës së bashku me 2 bashki të tjera është përfshirë në një projekt pilot. Projekti i financave lokale SEKO i qeverisë zviceriane në bashkëpunim me drejtorinë vendore të Ministrisë së Financave, ku është vendosur që menaxhimi i PBA të kryhet me 10 programe. Pra kjo është risia e PBA për bashkinë Korçë që menaxhimi i PBA do të bëhet me 10 programe. Ndërkohë në materialin e PBA është vendosur brënda afatit ligjor nga Ministria e Financave , pra 30 maj i këtij viiti. Afati ligjor është 1 qershor i vitit 2022. Këtë vit programi mund ti citoj janë:

- Planifikimi i Menaxhimit dhe Administrimit
- Siguria publike
- Mbështetja për zhvillimin ekonomik
- Mbrojtja e mjedisit
- Shërbimet publike vendore
- Shërbimet e kujdesit parësor
- Kultura, sporti dhe argëtimi
- Arsimi(ArsimiBazëpërfshirëArsiminParashkollor)
- Përkujdesi Social

PBA i bashkisë për vitin 2023-2025 përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korrente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disa vjeçare.

Hartimi i PBA të bashkisë për vitet 2023-2025 ka filluar që në muajin Janar me miratimin në Këshillin Bashkiak të parashikimit të të ardhurave afatmesme të bashkisë për këto vite buxhetore që po flasim. Mbas kësaj janë miratuar në Këshillin Bashkiak në muajin mars tavanet e përgatitjes së PBA dhe duke ju referuar miratimit të Këshillit Bashkiak të tavanëve ka vijuar puna për hartimin e kërkesave buxhetore duke ju referuar 10 programeve. Bashkia e Korçës në mbështetje të projektit SEKO të cilin duhet ta falenderoj për një punë jashtëzakonisht të përkushtuar që ka bërë me stafin e bashkisë, pra me drejtuesit e ekipeve të menaxhimit të programeve si dhe anëtarë që morrën pjesë dhe pavarësisht vështirësive arritën që të hartohet një

dokument i parë i PBA. PBA sipas viteve buxhetore pra në 2023 do të jetë me vlerën **1,919,861** pra me një rritje në krahasim me vitin 2022 do të jetë 1,6% , për vitin 2024 do të ketë rritje 2.2%, për vitin 2025 do të ketë rritje 2.3%. Theksoj që burimet kryesore të financimit do të jenë nga të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore për të cilët për vitin 2023 do të zënë 56%, për vitin 2024 do të zënë 55% dhe për vitin 2025 do të zënë 54%. Përveç të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore pjesë përbërëse janë edhe transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuar sektoriale në të cilën për vitin 2023 do të ketë një rritje transfertat e pakushtëzuar 6.7% në krahasim me vitin 2022, për vitin 2024 do të ketë një rritje 6.5% e krahasuar me vitin 2023, dhe për vitin 2025 do të ketë një rritje 6.6% e krahasuar me vitin 2024. Edhe planifikimi i shpenzimeve duke u bazuar në këto financiare pra të ardhurat nga taksat vendore, transfertat e pakushtëzuar, transfertat e pakushtëzuar sektoriale dhe pjesë përbërëse janë dhe fondet e deleguara të cilat për vitin 2023 2024 2025, funksioni i deleguar do të jetë edhe tek gjëndja civile për shkak sepse në fund të vitit 2022 mbyllet shërbimi i QKB dhe njëkohësisht dhe funksionet e përbashkëta të arsimit që konkretisht janë bursat për nxënësit e arsimit të mësëm profesional dhe arsimit parashkollor, njëkohësisht edhe shpenzimet që kryen për kuotat ushqimore të nxënësve të shkollës "Naim Frashëri". Shpenzimet janë parashikuar, pra siç ju thashë duke qënë se të ardhurat rriten nga viti në vit 1% të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore, ky trend është ruajtur edhe në llogaritjen e shpenzimeve referuar të dhënave të buxhetit të vitit 2021 dhe njëkohësisht të vitit 2022 dhe realizimit të shpenzimeve të vitit 2020-2021. Shpenzimet e personelit janë bazuar në strukturën, pra shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore në lidhje me punonjësit e miratuar për vitin 2022, pra është një rritje fare e papërfillshme. Në shpenzimet korrente janë marrë parasysh përveç shpenzimeve të llogaritura të buxhetit të vitit 2022 edhe angazhimet buxhetore disa vjeçare dhe këtu theksoj angazhimet buxhetore për shërbimin e pastrimit, për transportin urban, shërbimet e mirëmbajtjes së varrezave. Ndërsa vlen të theksohet edhe investimet në këto vitet buxhetore që po flasim janë parashikuar në rritje dhe konkretisht investimet në infrastrukturë rrugore. Nëse në vitin 2022 janë parashikuar në vlerën 70,000,000 lekë, për vitin 2023 janë parashikuar 108,536,000 lekë, për vitin 2024 dhe 2025 paraprakisht është rreth 124,500,000 lekë. Ndërsa investimet në arsim janë në kuotën e vitit 2022 pra 30,000,000 lekë duke ditur që këto do të jenë me bashkëfinancimin e qeverisë. Përveç kësaj, mbas duhet të përgjigjet edhe në lidhje me rekomandimet që jep Ministria e Financave. Këto rekomandime kanë erdhur dje dhe sot do ja ndaj komisionit të financave dhe kryetarit të këshillit bashkiak. Nga rekomandimet duhet të citoj disa. Pra Ministria e Financave dhe Ekonomisë vlerëson punën e kryer nga bashkia për hartimin e buxhetit afatmesëm 2023-2025. Buxhetimi mbi bazat produktive dhe kostimi i tyre përbën një punë shumë të mirë të bashkisë në drejtim të hartimit të buxhetit në përputhje me standartet ligjore. Rekomandimet që jep ministria janë që në fazën e parë buxheti u hartua në 7 programe, do të referohem më shumë udhëzimit që ka vendosur ministria që për këto bashki do të jenë për 10 programe dhe kjo do të korrigjohet në fazën e dytë të buxhetit, me miratimin e tavanit dhe njëkohësisht të buxhetit në fazën e dytë. Rekomandim për këshillin e të gjithë drejtuesve të ekipit të menaxhimit të anëtarëve të çdo programi. Njëkohësisht kërkohet që në të gjitha programet që do të hartohen të plotësohen të gjitha objektivat, treguesit e performancës për çdo program dhe bashkia duhet të hartojë produktet që janë të matshëm. Vëmendje e veçantë të synohet një rritje e investimeve publike duke ulur në nivelin e shpenzimeve të personelit në mënyrë që të rritet efienca e ofrimit të

shërbimeve. Ndërkohë buxheti gjithashtu buxheti afatmesëm duhet të rritë plotësisht vizionin e zhvillimit dhe planin e përgjithshëm vendor me qëllim ofrimin e zhvillimit të prekshëm nga qytetarët. Vlen të theksoj se hartimi i buxhetit në fazën e parë ka pasur shumë vështirësi, ka pasur terminologji të reja që nuk janë hasur më parë, megjithatë ne ja arritëm të dalim me sukses dhe të gjitha këto rekomandime do të konsiderohen si pozitive nga ana Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni ka diçka për të shtuar ose diskutuar? Bëtë mbledhje? Nga këshilltarët ka diçka për të diskutuar? Si praktikë do të votohet.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 9 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E FONDIT PREJ 500,000 LEKË SHPENZIME AKOMODIMI PËR PROJEKTIN CODE-X.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni ju lutem.

Këshilltare M.Nene: Sqarimi vazhdon me atë se çfarë është projekti Code-x, ku synimi kryesor i tij është transformimi i qytetit të Korçës në një qëndër rajonale të kampeve verore me fokus teknologjinë, sipërmarrjen, artin dhe sportin për fëmijët dhe kjo besoj është në vazhdimësi të të gjithë përprojekteve që ka ndërmarrë Bashkia e Korçës për fushën e teknologjisë dhe të informacionit. Ky është një projekt i cili në këtë fazë që jemi duke folur përfshin 120 nxënës të klasave të mesme nga e gjithë Shqipëria dhe ata do të përfitojnë si pjesë e programit 3 vjeçar mbi zhvillimin dhe edukimin në teknologji dhe mentalitetin krijues. Ky kamp 2 javor do të zhvillohet në Korçë në datat 18-29 korrik 2022 ku do të marrin pjesë 120 nxënës nga e gjithë Shqipëria për të mësuar 2 gjuhë të programimit. Sqarimet janë dhënë akoma më të hollësishme për 2 javë intensive me 80 orë leksioni interaktive dhe si pasojë e kësaj kërkohet dhe akomodimi i tyre në konvikt. Duke qënë se kemi një rritje të numrit të nxënësve që do të jenë pjesëmarrës edhe të Akademisë 2 javore që do të zhvillohet në qytetin e Korçës por edhe të programit 3-vjecar është kërkuar rritja e këtij fondi të planifikuar me vlerën 500,000 lekë për projektin që isha duke cituar deri tani. Kjo rritje e fondit do të shërbejë për akomodimin dhe shpenzimet e nevojshme të 120 nxënësve që do të qëndrojnë në konviktin "Ndërmarrja Trajtimi i studentëve sh.a", Korçë. Fondi për shpenzimet e akomodimit me vlerën 500,000 lekë do të përballohet nga fondi i planifikuar në buxhetin e vitit 2022 për vendime gjyqësore në programin planifikimi, menaxhimi dhe administrimi me këtë strukturë. Pakësohet llogaria ekonomike me strukture 602 me 500,000lekë

dhe shtohet llogaria ekonomike me strukturë 604 me 500,000 lekë në Programin Arsimit Bazë përfshirë dhe Arsimin Parashkollor.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po them dhe unë disa fjalë për ta shpjeguar projektin pasi është interesant. Është një projekt i sjellë në kuadrin e programit të madh për mbështetjen e sektorit të teknologjisë, informacionit në qytetin e Korçës dhe në Bashkinë e Korçës. Kemi folur disa herë edhe këtu në këshill për projekte të ndryshme. Pra qëllimi i përgjithshëm i këtij programi është që të trajnojë të rinjtë dhe t'ju japë njohuri në disiplina të ndryshme që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe ti përdorë pastaj këto aftësi të të rinjve dhe këto njohuri, për t'ju krijuar atyre mundësinë që të punojnë online për tregun ndërkombëtar pa qënë e nevojshme të largohen nga Korça. Është një program shumë i rëndësishëm pasi synon të mbajë të rinjtë dhe të rehat në qytet duke e tejkaluar barrierën që kemi neve për të qënë një qytet i vogël dhe një treg relativisht i vogël. Brënda këtij programi ka shumë projekte, projekti aktual targeton nxënësit që mbarojnë klasën e 9 dhe kalojnë në gjimnaz, pra në shkollën e mesme dhe i shoqëron këta nxënës që do të përzgjidhen për një periudhë 3 vjeçare, për gjithë kohëzgjatjen e shkollës së mesme. Është një projekt që është ideuar nga ish studentë të universitetit të Stenfordit në Kaliforni që është një nga universitetet më të mira në SHBA dhe në botësidomos për degë që lidhen me teknologjinë dhe është aplikuar nga ana e këtyre studentëve të Stenfordit në disa vende të botës. Në Shqipëri ka erdhur për herë të parë në Code for Albania para disa vitesh dhe është zhvilluar në Tiranë. Po t'ju kujtohet këtu në këshill kemi miratuar edhe mbështetjen që Bashkia e Korçës ju ka dhënë 6 nxënësve për të qënë pjesë e këtij projekti, që fillimisht u zhvillua në Tiranë. Nisur edhe nga feedback-u shumë pozitiv që kam pasur nga këta nxënës që ndoqën kursin e parë, ne kemi biseduar me organizatorët që ta transferojmë tani projektin në Korçë. Projekti do të organizohet në Korçë, do të ketë pjesëmarrës 120 nxënës që do të mbarojnë klasën e 9, do të ketë një kohëzgjatje 3 vjeçare dhe në çdo vit do të ketë një kam 2 javor veror, këtë vit do të bëhet 18-29 korrik dhe pastaj edhe një lloj mentorimi apo ndjekje të themi online përgjatë vitit, me seanca që mund të jenë një herë në muaj minimalisht ndërmjet këtyre nxënësve dhe instruktorëve të tyre amerikanë. Kurrikula është shumë interesante sepse ka edhe pjesën teknike me të cilën nxënësit do të mësojnë njohuritë e para të programimit në disa prej gjuhëve më të përhapura dhe më të përdorshme sot, sic janë Java, Python etj , por po aq i rëndësishëm është edhe komponenti tjetër që i mëson këto elementët e parë të të menduarit kritik dhe të analizuarit të gjërave , pra që nga identifikimi i problematikave të ndryshme gjetja e opsioneve për zgjidhjen e këtyre problematikave dhe përdorimin e teknologjisë për ti materializuar këto zgjidhje. Kurrikula përveç kësaj pjesës teknike dhe është e kombinuar edhe me aktivitete të tjera si eskursionet aktivitetet sportive, pra është një model Amerikan që nga eksperiencia e nxënësve që ndoqën kursin e parë ishte një kurikul shumë atraktive dhe jo e besdisshme. Unë besoj shumë që të kemi shumë fitues nga qyteti i Korçës pasi konkurrimi ka qënë i hapur , janë bërë 215 aplikime, 160 janë që plotësojnë kriterin e moshës, pasi ka pasur edhe aplikime që dilnin jashtë moshës 15 vjet

që është mbarimi i 9-vjecares. Me ka 160 nxënës do të për zgjidhen fituesit me një intervistim që do të kryhet nga ana e organizatorëve . Shpresoj shumë që të kemi sa më tepër nga Korça, nga Bashkia e Korçës, edhe nga bashkitë rreth e rrotull patjetër të ketë edhe nga Tirana edhe nga qytetet e tjera. Jam i interesuar specifiku për nxënësit e bashkisë së Korçës dhe bashkive rreth e rrotull nesh që mund të kemi pastaj kontigjente për ti bërë pjesë e projekteve të tjera që ne kemi për grupmoshat më të mëdha se grupmoshat e gjimnazit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Përgjatë këtyre 3 viteve, projektet që kemi mbështetur , unë do sugjeroja personalisht që të mendohet një metodologji ose inteks se si mund të matet efekti i shtrirë në kohë i këtyre investimeve apo shpenzimeve të projekteve që kemi mbështetur gjatë këtyre viteve në këtë fushë, në fushën e teknologjive të reja të informacionit, sepse në rast se flasim për shpenzimet që bëjmë për rrugën e kemi të qartë , në rast se flasim për mbështetjen që i kemi dhënë zhvillimit ekonomik, sektorit të turizmit është e dukshme e prekshme, ndërsa për këto projekte që kemi mbështetur dhe do të vazhdojmë të mbështesim, gati në çdo mbledhje kemi pasur nga një material që ka lidhje me këtë fushë, që është një program shumë i rëndësishëm dhe i besoj shumë personalisht, por duhet të mendojmë një metodologji që si të matet, po jep efektet që ne presim apo nuk po jep dhe çfarë modifikimi duhet të bëjmë për të ardhmen. Ky ishte një sugjerim dashamirës, pra metodologjia, ku për fat kemi një institucion si universisteti që ka specialistë që mund të kontraktohen apo të asistohen për të punuar rreth një metodologjie që ekziston dhe të mendojmë dhe një shpenzim për këtë çështje , se nuk bëhen dot vullnetarisht , për të matur efektin që ka sot dhe nesër, të gjitha këto shpenzime që ne bëjmë për këtë fushë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Patjetër disa indikatorë mund të vendosen dhe mund të matet. Edhe nxitja ime kryesore për ta sjell këtë projekt në Korçë ka qënë feedback-u që unë kam marrë nga nxënësit e parë ka qënë shumë pozitiv, qoftë për periudhën që ata kanë ndjekur kursin edhe njohuritë që kanë marrë, se përfitimet për ndjeksit janë të shumta , duke filluar nga njohuritë teknike në gjuhë programimi, njohuritë e tjera në këtë pjesën e të menduarit kritik, krijimi i një netëorku lidhje me bashkëmoshatarët e tyre nga qytetet e tjera apo dhe nga qyteti i Korçës, krijimi i një netëorku i lidhjeve edhe me instruktorët amerikanë që jo vetëm kanë mbaruar Stenfordin por janë të gjithë të punësuar në kompani të tekonojgisë shumë të njohura, facebook, google dhe kompani të tjera të njohura në botë, dhe pastaj perspektiva e tyre e punësimit. I takon tani edhe në kuadrin e promovimit të këtij projekti dhe nga 6 studentë , 4 prej tyre edhe zgjidhjen për degën e studimeve universitare e kishin bërë të lidhur me teknologjinë e informacionit dhe spontoja kishte qënë pikërisht nga projekti CODE FOR ALBANIA. Patjetër që duhet të monitorohet edhe në vazhdim, por ai impresion apo feedback-u që kemi deri tani është shumë pozitiv, dhe shpresoj të ngelet i tillë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Edhe unë në atë kontekst e kisha padiskutim që efektet pozitive i perceptojmë por dhe për publikun e gjërë duhet që të ketë një metodologji që të matë të gjithë

indikatorët që ju përmendët për këtë rast, por edhe për edhe për projektet e tjera që kemi në këtë linjë që ne po i mbështesim, apo kemi hedhur hapa siç është dhënia e hapësirave publike e kështu me rradhë të jenë disa indikatorë që publiku ta kuptojë që këto para nuk janë të hedhura për disa projekte apo aktivitete futuriste por janë të prekshme, siç unë i besoj me intuitën time dhe me ato që juve thatë. Një metodologji e përcaktuar mirë që përsëritet në kohë, që e mat efektin e tyre , unë them që do të na ndihmojë, që mbase duhet dhe më shumë fonde për këtë qëllim, se këto mundësi që kemi pasur ne kanë qënë të pakta, mbase duhen më shumë. Pse jo 400 fëmijë për shëmbull.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Këtë projekt se ja vlen të themi, ai kontributi i bashkisë është vetëm një pjesë e financës të projektit pasi ne e kemi promovuar edhe në donatorë dhe na janë bashkuar si bashkë financues donatorë, organizata shumë të rëndësishme që merren me fëmijët dhe të rinjtë , UNICEF, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe të Rinjtë dhe World Vision janë dy prej organizatave që e mbështetin financiarisht këtë projekt. Patjetër që kjo pjesa e indikatorëve duhet bërë. Për çdo projekt ja vlen që të matësh rezultatin edhe arritjet të themi të projektit.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM

Pika 10 e rendit të ditës

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR.147 DATË 22.12.2021 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR 2022 TË BASHKISË KORÇË"

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni ju lutem.

Këshilltare M.Nene: Në vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 147 datë 22.12.2021 "Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë", është miratuar buxheti vjetor 2022, në të cilin në pikën 5 është miratuar numri total i punonjësve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike 425 punonjës. 31.03.2022 , me vendimin nr. 48 është bërë ndryshimi i këtij vendimi të këshillit bashkiak "Për Miratimin e Buxhetit 2022 të bashkisë Korçë dhe u ndryshua numri i punonjësve në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike nga 425 punonjës në 428 punonjës. Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 i Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" dhe në VKB nr. 147 datë 22.12.2021 "Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë", i propozojmë Këshillit Bashkiak që të ndryshohet pika 5 i vendimit dhe të shtohet numri i punonjësve në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike nga

428 që ka qënë e fundit ndryshimi që kemi bërë në datën 31.03.2022 në 438 punonjës. Efektet financiare do të përballohen nga buxheti i miratuar i vitit 2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 11 e rendit të ditës

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.137 DATË 25.11.2021 "PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORCËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2022"

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Sërish komisioni.

Këshilltare M.Nene: Në relacion është përmendur baza ligjore, besoj të gjithë e keni lexuar dhe propozohet si më poshtë për të ndryshuar tarifën në rast të zëvendësimit të lishencës së tregëtimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj. Arsyet kanë qënë sepse referuar krizës ekonomike ku më i prekshëm ka qënë sektori i energjisë, por jo vetëm për këtë, rezulton mos stabiliteti nëçmim të hidrokarbureve. Kjo ka sjellë si pasojë dhe daljen nga tregu i tregëtimit me pakicë të hidrokarbureve në konsumatorët të subjekteve që zhvillojnë aktivitetin në territorin e bashkisë Korçë. Disa raste të konstatuara në stacionet e tregëtimit me pakicë të hidrokarbureve të cilët kanë dalë nga tregu, këto janë zëvendësuar me subjekte të tjera dhe kjo bën që ato duhet të pajisen me zëvendësimin e elementëve të liçensës bazuar në një afat 5 vjeçar të tregëtimit me pakicë të hidrokarbureve për konsumatorët. Tarifat për këto duplikata të efiçencave, në bazë të vendimit sepse përmendet baza ligjore e tyre është 20% e vlerës së plotë 1,000,000 lekë e cila është në vlerën 200,000 lekë dhe kjo vlerë e cila po ta shikosh në llogjikën ekonomike rëndonte më shumë tek situata e operatorëve ekonomik pasi duhet të paguhej e njëjta vlerë si në rastin kur zëvendësimi mund të bëhej në vitin parë ose në vitin e dytë, apo kur ishte në muajt e fundit të vlefshmërisë së liçensës. Për këtë arsye është propozuar ndryshimi i kësaj tarife në rastin e zëvendësimit të liçensës dhe konkretisht është propozuar një ndryshim i tillë: me rastin e zëvendësimit të liçencës me bazë 5 vjeçare që ka si qëllim ndryshimin e elementëve të përdoruesit të stacionit të pajisur me licencë bazë , tarifa do të jetë 20,000 lekë për çdo rast zëvendësimi për diferencën e periudhës kohore të papërfunduar. Ndryshimi i elementëve të përdoruesit të stacionit përfshin rastet kur kanë të bëjnë me ndryshimin e emrit të subjektit dhe rastet me ndryshimin e numrit unik të identifikimit të subjektit të regjistruar në Q.K.B. Është një

material që është aktual në lidhje me të gjitha problematikat që ka sjellë situata aktuale përse i takon tregut të hidrokarbureve dhe duket që është një vendim të themi që i përshatet dhe besoj se do të ndihmojë edhe konsumatorët finalë të tyre.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë kam një pyetje në lidhje me këtë licenca është për pikën apo është për subjektin? Licenca është për ndërtesën? Se po qe se është për subjektin kjo s'vlen.Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Këshilltare I.Nikaj: Nuk e kisha materialin, nuk e kam parë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Zysha po ju e kishit në rendin e ditës.

Këshilltare I.Nikaj: Ka një mungesë të informacionit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po mirë pra dakord, nuk kam asnjë kundërshtim, ka mungesa ka gabime, po jo kur ecën materiali dhe pastaj prit se nuk e kisha materialin nuk e kam parë. Nuk e di.

Këshilltar Sh.Kajmaku: Abstenon ajo sepse nuk ka dijeni të plotë, s'ka ndonjë gjë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Jo dakord nuk kam problem me mënyrën e votimit edhe unë vetë mund të abstenoja s'është problem. Atëhere 1 abstenim.

Pika 12 e rendit të ditës

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR .23 DATË 10.02.2022 "PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVILPËR INSTITUCIONIN E BASHKISË KORCË PËR VITIN 2022"

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Anxhela do thuash ndonjë gjë shkurt që të ta lehtësoj pak.

Ekzekutivi A.Dishnica: Kjo ka të bëjë me një pozicion të shërbimit civil të cilin ne duam ta rekrutojmë nga jashtë shërbimit civil. Në planin vjetor kemi parashikuar që të rekrutojmë nga jashtë shërbimit civil për pozicionin Drejtor i Drejtorisë të Kujdesit Social, ndërkohë që ky pozicion u plotësua, por meqënëse ne jemi brënda % të numrit për të plotësuar këto nivele jashtë

shërbimit civil, propozojmë që të shtohet edhe Drejtori i Drejtorisë së Projekteve, Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Migracionit dhe Diaspores. Pra i vetmi ndryshim ky është.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga komisioni duan të shtojnë ndonjë gjë rreth kësaj? Nga këshilltarët ka diçka për të pyetur për këtë çështje ?

Këshilltare I.Nikaj: Këto vënde mungojnë, nuk janë plotësuar?

Ekzekutivi A.Dishnica: Jo janë vakante.

Këshilltare I.Nikaj: Unë mendoj që Përgjegjës i Sektorit për Emergjencat Civile duhet të plotësohet.

Ekzekutivi A.Dishnica: Po pra është dhe ai.

Këshilltare I.Nikaj: E kam fjalën që nuk është mirë të jetë dikush i komanduar në këtë sektor. Është diçka e rëndësishme.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po kryetar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jam dakord, e kemi si prioritet për ta plotësuar si pozicion.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 13 e rendit të ditës

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË NR.26 10.02.2022.

Këshilltar Sh.Kajmaku: Pjesa që i ka kaluar bashkisë është parashikuar nga bashkia që ka qënë trualli i lirë komplet ndërsa hipoteka ka konstatuar që brënda kësaj sipërfaqe ndodhet një gabinë elektrike me sipërfaqe 82m2 dhe kërkohet qëkjo sipërfaqe e kësaj kabine të hiqet. Pra nga 15,300 m2 të hiqet 82 m2.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka ndonjë gjë për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0
Vota ABSTENIM 0

Pika 14 e rendit të ditës

PËR KALIMIN E PRONËSISË SË TRUALLIT PREJ 300 M2 TË DHËNË PËR NDËRTIM NGA KËSHILLI I ISH KOMUNËS DRENOVË NË EMER TË Z.NIKO TELHA NË FSHATIN MORAVË, NJËSIA ADMINISTRATIVE MORAVË.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kjo pika ka lidhje me pikën 15 PËR KALIMIN E PRONËSISË SË TRUALLIT PREJ 400 M2 TË DHËNË PËR NDËRTIM NGA KËSHILLI I ISH KOMUNËS MOLLAJ NË EMËR TË Z.PETRIT PANE NË FSHATIN MOLLAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAJ. Anxhela të lutem shkurt fare.

Ekzekutivi A.Dishnica: Jo se kanë lidhje të dyja me njëra tjetrën.

Këshilltari Sh.Kajmaku: Kanë bazë ligjore të njëjtë.

Ekzekutivi A.Dishnica: Bëhet fjalë për kalim e truallve, është miratuar dhënia e truallit nga këshillat e komunave respektive dhe më pas është miratuar dhe leja e ndërtimit. Por që të bëhet kalimi final i pronësisë së truallit tek këta subjekte duhet që të plotësohen edhe me kontratën e shitblerjes. Për këtë arsye është paraqitur në këshill që të miratohen kalimi i pronësisë së truallit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Këto janë më 25 vota. Atëhere ngelet për votim herës tjetër.

Pika 16 e rendit të ditës

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR PRIVATIZIMIN E OBJEKTIT ME SIP TRUALL 559,6 M2 NGA TË CILAT 380 M2 NDËRTESE, TË NDODHUR MBI PASURINË ME NR 1/931 ZK 8561, NË ISH PARKUN AUTOMOBILISTIK KORÇË.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po Anxhela.

Ekzekutivi A.Dishnica: Kemi patur një kërkesë nga Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë e cila kërkon dhënien e pëlqimit nga Këshilli Bashkiak Korçë për privatizimin e truallit të ndodhur tek ish parku automobilistik. Duke qënë që bashkia më nuk ka aktualisht ndonjë projekt zhvillimi mbi këtë pasuri, kemi lejuar që të fillojë procedura e legalizimit. Pra në këtë mbledhje jepet pëlqimi për të filluar procedura e privatizimit, ndërkohë vlerësimi i pronës dhe privatizimi bëhen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kjo me sa vota është Anxhela.

Ekzekutivi A.Dishnica: Ky është thjesht dhënie pëlqimi, nuk është transferim pronësie .

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22
Vota KUNDËR 0
Vota ABSTENIM 0

Pika 17 e rendit të ditës

PËR MIRATIM HAPJE DRITE NË PRONË NË SHTET.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni

Këshilltar K.Andrea: Kjo kërkesë ka erdhur nga qytetari Polizoi Mindilisi pronar i pasurisë nr. 1/407, zona kadastrale 8563, kërkon hapjen e dritës në pjesën jug-lindore të pronës së tij, në drejtim të pasurisë shtet, e sistemuar nga Ndërmarja e Shërbimeve publike si lulishte midis pallateve të bllok banimit tek lagja 13, Rr. Vaskë Dushku, sipas planvendosjes bashkëngjitur. Zotëria ka aplikuar një lejë ndërtimi private dhe kërkon që nga ana e lulishtes të hapë dritare. Ne si komision e shqyrtuam dhe jemi dakord.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kjo rruga nuk ka lidhje me një konflikt që na ka ardhur.

Ekzekutivi Zh. Lubonja : Janë pallatet në rruga Partizani dhe kjo është mbrapa pallateve.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mos është një konflikt që erdhën këtu një herë qytetarët. Kjo rruga Vaskë Dushku, ju kujton diçka? Ndoshta mund ta kem unë gabim.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Janë 2 pallate bashkë, dhe mbrapa janë shtëpi private. Lulishtja është mbrapa pallatit në rruga "Vaskë Dushku"

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka? Unë personalisht në fakt jam që publiku të ketë një lloj mbrojtje se ka shumë vite që është sulmuar në favor të privates dhe se di këtu po që se nuk e miratojmë çfarë i prish punë këtij zotërisë?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: I çenohet pjesa e dritës.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nuk i takon jo se i çenohet.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani shiko dhe për ta sqaruar, se patjetër dhe ne përfaqësojmë pjesën publike dhe si bashki dhe interesi jonë është që ta ruajmë pjesën publike, por sipërfaqet në pronësi të bashkisë mund ti ndajmë në kuptim të kësaj kërkesë në dy lloje sipërfaqesh. Në sipërfaqe truall ku bashkia sot, nesër pas disa vitesh mund të zhvillojë dhe të ndërtojë diçka dhe në këtë rast nuk ju kemi dhënë dhe as nuk do ju japim miratim për të ndryshuar kondicionet urbane dhe të çenohet interesi jonë në përdorimin e kësaj sipërfaqe dhe në sipërfaqen si në rastin konkret si dhe në raste të tjera që kemi miratuar, ku janë sipërfaqe që ne i kemi sistemuar dhe ja u kemi dhënë destinacionin në trajtën e lulishteve, hapësirave të gjelbra dhe nuk planifikojmë të bëjmë ndërtimepublike të bashkisë. Lulishte të tilla në Korçë ka shumë, pjesa më e madhe e hapësirave brënda pallateve ju e dini si i kemi gjetur ne 2007 në këtë zonën me garazhe dhe i kemi sistemuar dhe i kemi kthyer ne lulishte, dhe ato të gjitha janë të kufizuara me pallate që i kanë dritaret mbi këto lulishte dhe ne nuk na prishin ndonjë punë sepse ne nuk kemi ndonjë plan

që të ndërtojmë mbi këto lulishte objekte publike. Pra duhet ndarë kuptimi i këtyre kërkesave, çfarë janë treje që ne mund ti përdorim për të ndërtuar dhe ku ne nuk lejojmë cënim të kondicioneve urbane dhe çfarë janë lulishte të formuluar dhe të investuara që do të qëndrojnë lulishte si ato që kanë qëndruar me përpara dhe që kanë dritare sipër. Në këtë kuptim gjykoj se nuk mund ta pangojmë atë investitorin që të ndërtojë pak më shumë seç do të ishte po të kishte në kufi me truallin, për sa kohë që ne nuk na prish ndonjë punë edhe mund ta lejojmë. Nuk është se po cënon interesin publik. Interesi publik, lulishtja nuk do të cënohet nga zhvillimi në fjalë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atje ka dritare në katin e parë, lulishtja cënohet sepse nuk mund ti vejnë atje afër.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ata mund ti venë, ai do të ketë problem, por neve nuk na prish punë sepse e ka kërkuar vetë këtë problem.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ne gjithmonë duhet të mendojmë atë se çfarë mund të krijojë pasoja që mund të krijojmë. Dhe pasoja që mund të krijojmë është se aksesimi i qytetarëve i fëmijëve në kjo lulishte ngushtohet sepse nuk mund ti vejë në dritare ti rrijë. Apo jo Zhani?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Lulishtja është bërë në atë formë që nuk vete deri në fund të pronës. Ajo është pjesë e gjelbër.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pastaj është historia kush është më i fortë në lagje.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Stolat janë vendosur në distancë. Dhe tjetër nga ana vizive më mirë është të shikosh një mur më dritare sesa një mur kallkan.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Do shikosh lule dhe pemë.

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Po i ke lulet dhe pemët, nuk i hiqet e drejta për të pasur dritare.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Domethënë ajo që po thotë Zhani është që në një mur kallkan ai mund të bjerë 1 m² nga kufiri i pronës. Po ta bëjë kallkan murin mund të vijë 1 m² nga kufiri i pronës. Po ta bëjë me dritare, ligjërisht po të ishte në pronën ku ne do zhvillonim do largoheshë numri i kateve +1 m². Sa largohet tani?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Tani nuk largohet.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk vjen pra në kufi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po në kufij vjen.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po si në kufi?

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Këtë lejë që ne japim e vendosim në kufij 25cm.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ky është kuadri i përgjithshëm, pastaj vendimarrjen gjykojeni ju. Unë e kam si parim që dua të mbaj të njëjtën dorë në vendimarrje për të njëjtën gjë pra si në rastet e kërkesave të tjera. Bëhet fjalë për hapësirat publike që janë të formuluar në trajtën e lulishtes, pra nuk janë truall i lirë që bashkia të ndërtojë diçka. Ja kemi dhënë destinacionin si lulishte e

para dhe e dyta mbase mund të vendosnim qetë lejohej hapja e dritares 1m larg sa do ishte me kallkan.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Si ishte fituar kjo pronë?

Ekzekutivi Zh. Lubonja: Është e trashëguar. Ne marrim çertifikatë pronësie, sesi është fituar nuk e di.

Këshilltar K.Andrea: Ideja është që aty është një lulishte midis pallateve. Kështu që atje dritare ka aktualisht.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po nuk diskutohet, këto të gjitha janë hapësira lulishteje ku ka dritare. Siç janë të gjitha hapësirat ndërmjet pallateve. Dritare ke nga ana e lulishteve.

Këshilltar Sh.Kajmaku: Vitet më përpara i kemi lejuar, kështu që.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë them se e kemi bërë këtë diskutim edhe herët e tjera. Okay hajde e bëjmë edhe këtë rradhë se nuk na kushton gjë. Ti heqim një vizë të vendosim disa standarte dhe mos e bëjmë këtë çdo mbledhje se një dorë do mbajmë, s'mundet njërit ti themi jo dhe njërit ti themi po. E kemi gjykuar në fillim, meqë e kemi sjellë si propozim që interesi publik nuk cënohet sepse janë lulishte dhe lejohet qytetari me një gjë që neve nuk na prish punë. Hajde e mbyllim këtë diskutim. Të kemi një vendimmarrje dhe të mos i rikthehemi çdo rasti se themi të njëjtat gjëra. Kjo është situata, interesi jonë publik nuk cënohet sepse janë lulishte që ka pallate rreth e rrotull dhe ne nuk kemi në plan të ndërtojmë që të duhet pastaj të largohet, të respektohen distancat. Në një mbledhje mbase mund ta bëjmë edhe këtë dhe ta kemi si formë standarte i shtuar me propozimin tuaj dhe paragrafin që të njëjtën tolerim duhet pastaj ta zbatojmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ai po vuri dritare këtu atë kufizimin që keni vendosur ju dhe prona që ti ke iku , e vendosi ai dritaren, nuk është më e shiti.

Ekzekutivi Zh.Lubonja: Në këtë rastin konkret distanca me pallatin me dritaren është distanca fikse.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë nuk e kam parasysh fare.

Këshilltare I.Nikaj: Shiko adresën e keni gabim.

Këshilltar K.Andrea: Duhet theksuar që në material është gabim. Adresa është "Vaskë Dushku", ku duhet të jetë "Vaskë Pendavinji".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po ku është "Vaskë Pendavinji"?

Këshilltare I.Nikaj: Lagjia 13. Me lejë kryetar.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka ardhur një kërkesë nga kjo noterja për nga "Vaskë Dushku". Nuk e di çfarë është.

Këshilltare I.Nikaj: Në "Vaskë Dushku" nuk ka të tilla, meqë e njoh prandaj ju thashë. Unë ju thashë që e keni gabim adresën.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po mbase mund të jetë "Vaskë Pendavinji".

Këshilltar K.Andrea: Është Vaskë Pendavinji, sepse po të shikojmë bashkëngjitur hartës kadastrale është shkruajtur Vaskë Pendavinji.

Këshilltare I.Nikaj: Me lejë të them 2 fjalë, se ne e kemi diskutuar këtë. Në përgjithësi unë mendoj që ne jemi këtu për të mbrojtur interesat e pronës publike e para dhe supozoni në një situatë hipotetike mendoni, privati do të na bënte ne ndonjë lëshim të kësaj natyre nëse do të kërkonim për interesa publike të ndërtonim diçka të tillë? Se kam parë deri tani , megjithatë ju mund të thoni ndodh. Unë mendoj që pronës publike nuk duhet t'ja heqim të drejtat që ajo duhet të ketë në bazë të ligjit, derisa ligji e ka të shkruar, e ka të përcaktuar është mirë që t'ja lemë këto mundësi pronës publike sepse ajo dhe në të ardhmen mund të shkojë përtej interesave private që mund të shfaqen qoftë në trajtë dritare, qoftë në trajta të ndryshme. Deri tani ne i kemi dhënë lejë shumë të hapen apo të marrin dritë dhe kam parë që janë shfrytëzuar deri në fijen e flokut, s'është e drejtë e tyre. Nuk e mendoj që është kaq pozitive që ne të vazhdojmë të bëjmë të tilla gjëra më pronën publike. I kemi dhënë disa, e kemi parë të arsyeshme ta bëjmë këtë, por unë mendoj që është diçka që nuk duhet të jetë kaq e shpeshtë që vazhdimisht ti afrohet pakësimi i mundësive pronës publike për tu zhvilluar.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tani është bërë fakt i kryer.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo fakt i kryer nuk është bërë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tani do një qasje tjetër kjo punë, nuk mundet të funksionojë vetëm se kjo është e të gjithëve . Një parim i përgjithshëm.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Asgjë nuk është bërë fakt i kryer, fakt që ne kemi gjykuar kështu siç unë e thashë dhe unë i qëndroj përsëri kësaj që sapo thashë, që interesi publik nuk çenohet sepse ajo zonë është e përcaktuar si lulishte dhe atë ka përdorim publik siç janë të gjitha lulishtet në Korçë, shumë prej tyre që janë brënda pallateve dhe kanë dritare. Pra ne e kemi përcaktuar destinacionin e asaj zonës që do ta bëjmë lulishte, përndryshe e linim kështu shesh.

Këshilltare I.Nikaj: Tani ndryshoje.

Këshilltar K.Andrea: Po është më mirë kështu lulishte.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kristi ke konflikt interesi nuk duhet të prononcosh.

Këshilltar K.Andrea: Unë nuk prononcoj konflikt interesi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Përfaqëson një studio arkitekture. Tani të lutem.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mos e konsideroni sikur është bërë fakt. Unë i qëndroj kësaj që nuk e kemi dëmtuar interesin publik dhe ndërkohë kohë i kemi krijuar mundësinë në ato raste kur ka qënë e mundur që të rritim sipërfaqen e ndërtimit pa na prishur punë ne në planet tona të zhvillimit, sepse kemi pasur edhe raste tek godina e trikotazhit që ka qënë truall, kemi pasur kërkesa të kësaj natyre dhe kemi thënë jo sepse ne duam të zhvillohemi vetë. Por kur ka qënë rasti që ka qënë truall dhe mund të përdoret për zhvillim ju kemi thënë jo nuk e kemi sjellë fare këtu. Këto janë të tjera raste. Jeni të lirë që ta vendosni edhe ndryshe. Mos e merrni të

mirëqënë sikur u bë fakt edhe na keni sjellë një gjë që ne e gjuvojme që çenojmë interesin publik, nuk është ky rasti. Shikojeni diskutoheni, merrni kohë po të doni, qëndrimi im është i njëjti por mund të kemi edhe pozicione të ndryshme.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka ndonjë diskutim përpara se të kalojmë në votim? Kjo si duhet të trajtohet Gjergji me 25 apo me 21? Nëse ne nuk e japim si pëlqim, ai zotëria ka mundësi ndërtimi?

Këshilltar Zh.Lubonja: Ai ndërton në pronën e tij sepse distanca nga pallati është fiks. Është 10 metra. Ne nëse duam të ndërtojmë në pjesën tonë nuk ndërtojmë dot sepse nuk respektojmë distancën nga pallati. Ne si bashki.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ky zotëria nëse ne nuk ja japim miratim, mund të ndërtojë?

Këshilltare Zh.Lubonja: Mund të ndërtojë, e hap dritaren nga ana tjetër dhe këtej del kallkan me faqe pa dritare. Nuk ka ndonjë interes për ne të dalë faqe kallkan.

Këshilltare I.Nikaj: Po çfarë ndërtimi është miratuar? 5 kate 10?

Këshilltare Zh.Lubonja: 3 kate maksimumi.

Këshilltare I.Nikaj: Po mirë kallkan fare nuk është.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nuk ka rëndësi kjo. Po që se ne nuk japim pëlqimin ai mund të ndërtojë po ka zgjidhje tjetër, vetëm se do jetë kallkan muri këtej. Këtej nga komshinjtë ka ndonjë pretendim ndonjë ankesë? Se çështja është nuk duhet të marrim vendime që mund të krijojnë konflikte atje, se vjen njëri dhe thotë pse na hape dritare.

Këshilltare Zh.Lubonja: Pallati ka dritare në lulishteqë shikojnë në lulishte, ky mund të ndërtojë kallkan atje, por kallkan është një gjë e shëmtuar nga ana estetike. Ai do e ndërtojë atje, nuk kemi të drejtë ne ta pengojmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Padiskutim .

Këshilltare Zh.Lubonja: Ai po ndërton në pronën e tij.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ai po ndërton në pronën e tij dhe po kërkon që të mos respektojë këtë distancë nga ana e lulishtes. Lulishtja konsiderohet si një hapësirë që nuk do të ndërtohet, siç edhe do të ndodhë në fakt se ne nuk kemi ndërtuar në ndonjë lulishte deri më sot edhe nuk kemi në plan.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakord ka për të diskutuar dikush tjetër?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 2

Vota ABSTENIM 1

Pika 18 e rendit të ditës

PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT KËSHILLIMOR PËR DHËNIEN E TITULLIT QYTETAR NDERI Z.KRISTO FLOQI (PAS VDEKJES).

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Është një diskutim që është bërë para 6 muajve, para 1 muaji erdhi si kërkesë pavarësisht që e morëm të mirëqënë si kërkesë. Do ngrihet një komision që i diskuton titujt, ne 3 i kemi të përcaktuar apo jo profesor Pandi? Na duhen dy emra nga jashtë. Në një diskutim që bëra unë dhe me ekzekutivin propozoj dy emra : Jonela Spaho dhe Eris Rusi nga jashtë këshillit. Nga brenda këshillit e kemi komisionin e ngritur mos gaboj.

Këshilltare I.Nikaj: Mos është konflikt interesi se zonja e ka lëçitur shumë Kriston Floqin.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ata që e kanë lëçitur u merret vendimi të shpallet mos shpallet. Unë që se njoh farë ç'më pyet mua, ç'më thërret mua atje.

Këshilltare I.Nikaj: Tani këtu nuk duhet të ketë konflikt interesi. Pra dikush që ka marrë titullin profesor e asociuar me këtë do vijë ta mbrojë dhe të thotë të japim për publikun një informacion.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Më fal konflikt interesi po qe se do ishte babai i saj do ishte konflikt interesi. Po qe se nga kjo do kishte një përfitim financiar .

Këshilltare I.Nikaj: Përfitim financiar e ka se ka marrë të gjitha gjërat më këtë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po mirë pra se këtë studiuar. Këtë ka studiuar ajo. Tani ju kemi studiuar mos gaboj ma kujto pak ju lutem .

Këshilltare I.Nikaj: Branko Nezhanin .

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tani kë do pyesim për Bratkon? Do të pyes ty nuk do pyes Adelinën në shpi kur të vijë momenti për Brankon.

Këshilltare I.Nikaj: Branko Nezhanin.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ty do të pyes, se s'kam kë pyes.

Këshilltare I.Nikaj: Jo për ti dhënë Qytetar Nderi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Për çdo gjë po qe se duhet ta pyes dikë, po qe se ka lidhje me këtë. Me Branko Nezhanin unë ty do të pyes.

Këshilltare I.Nikaj: Po them jashtë kësaj.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Sa veta ka komisioni?

Këshilltare E.Mitre: 5 , po ajo është vetëm 1. 5 është komisioni, 3 janë të këshillit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në fakt janë 3 anëtarë të këshillit, edhe 2 njëri prej të cilit është edhe njohës i figurës.

Këshilltare I.Nikaj: Unë e kam si parim sepse nuk kam ndonjë gjë .

Këshilltar Sh.Kajmaku: I ka të përcaktuara ligji aftësinë e gjinisë, të krushqisë, i ka të përcaktuara.

Këshilltare E.Mitre: Nga dhënia e titullit të tij, përfiton personalisht Jonela? Ajo e ka studiuar dhe ka fituar titullin. Nëse ky merr titullin qytetar nderi ka përfitim Jonela?

Këshilltare I.Nikaj: Ku e di unë .

Këshilltare E.Mitre: S'ka përfitim. Ajo është 1 në 5 vota të komisionit, kurse këtu s'ka votim ajo. Ajo nuk voton këtu .

Këshilltare I.Nikaj: Po e them si parim, nuk e kam asnjë gjë .

Këshilltare E.Mitre: Jo dhe unë nuk e kam asnjë gjë.

Këshilltare I.Nikaj: Unë them në parim, që unë të propozoj Brankon dhe të marr unë vendimin për Brankon.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po jo jemi komision këshillimor, vendimin këtu dhe po qe se bëhet si propozim patjetër që do ta votosh se po qe se votove ti që e ke propozuar kush do ta votojë? Do ta propozoj unë herës tjetër një emër këtu, do ta mbroj si anëtar jo si kryetar. Më fal po nuk e votova unë si do t'ju kërkoj juve ta votoni .

Këshilltare I.Nikaj: Rregullorja për propozimet është që vjen një person i miratuar që propozon për titujt.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Më fal po qe se propozoj emrin tim, po ka konflikt interesi. Të propozosh njerëz patjetër, ti që i njeh do i propozosh. Profesor me fal.

Këshilltar P. Bello: Unë e kam cilësuar në librin tim Kristo Floqin, po ja u them që kam konflikt interesi. E njoh familjen e të mbesës së tij në Tiranë. Mund të quhet edhe kjo konflikt interesi, por ti lemë këto gjëra dhe të flasim për këtë figurë , i cili ka një histori që nuk përsëritet dhe nuk është histori private. Kristo Floqi është autor i vërtetë i mbledhjes për bashkimin e shoqërive të Shqiptarëve të Amerikës në Federatën Vatra. Do mjaftonte vetëm kaq sa të mbaronte çdo lloj diskutimi që ne po e zgjasim dhe mua po më vjen zor për këtë, por unë kam për ta vazhduar pak më tej.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Profesor më fal, nuk po diskutojmë e meritonte se meritonte titullin. Unë po them këtë që mos e keqkuptoni. Të lutem se duket sikur vemë në diskutim figurën e Kristos. Diskutiam thjesht propozimin.

Këshilltar P. Bello: Dua ta kaloj pak shkurt sepse është shumë e rëndësishme. Tani e dëgjojnë të gjithë në televizor Federata Vatra. Federata Vatra ka pasur pikërisht këta Korçarë, banorë të rajonit të Korçës, nuk po them vetëm Korçarë që janë 4 të shquar. Tani mund të mburresh se je kryetar i Federatës Vatra por atëhere luftoje për ekzistencës e shtetit Shqiptar dhe ata kanë luftuar. Kristo Floqi menjëherë pas shpalljes së pavarësisë ndodhet në Vlorë dhe për këtë arsye sipas njohjes së figurës së tij, deputet i Dibrës apo i Korçës, drejtues gazete në Vlorë apo në Shkodër. Ai duhet të ishte qytetar nderi edhe në Vlorë edhe në Shkodër edhe në Dibër edhe në Korçë në mënyrë të padiskutueshme .

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Profesor të lutem po diskutojmë emrat e komisionit. Këtu ke në rend të ditës ngritjen e komisionit jo diskutimin e emrin. Ke ndonjë propozim për emër veç atyre emrave që thashë unë?

Këshilltar P. Bello: Jo, nuk kam.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atëhere për diskutimin e figurës së Kristo Floqit ju do diskutoni në komision do vini këtu në këshill për të votuar për emrin e Kristo Floqit. Që të mos dalim nga fokusi. Për emrat keni ndonjë propozim tjetër. Meqë nuk keni propozim tjetër kush është dakord për ngritjen e komisionit më përbërjen 3 të përhershmit dhe 2 Jonela Spaho dhe Eris Rusi.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Këshilltare I.Nikaj: Ka ardhur një kërkesë për këtë?

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po ka ardhur një dokumentacion paraparak. Edhe njëherë sot nuk po vendosim dhënien e titullit. Një material është shpërndarë tek ju. Material ku është shfaqur propozimi. Sot nuk po japim titullin, po ngremë komisionin. Tani komisioni ti marrë në shqyrtim edhe ndonjë propozim që mund të keni. Kur të vijë propozimi në këshilli mund të vijë po jo mundet. Pastaj ka dhe një pozicion ligjor që na jep një sugjerim për të verifikuar emrat. Kur ka vdekur Kristo Floqi?

Këshilltare I.Nikaj: Në 1951.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atëherë vlen dhe për këtë, duhet dërguar shkresa për verifikim se na i ka kërkuar agjensia përkatëse. Pra kije parasysh ta respektojmë atë që të mos shtyhet pastaj dhe të themi se s'na ka ardhur dhe kjo. Ta çojmë në kohë. E çojmë ne apo ekzekutivi. Pra komisioni u ngrit, miratimi i titullit është herën tjetër. Do të plotësohet dosja me ato që kërkon edhe këtë që parashtruat.

Sekretare E.Naçi: Kryetar mund të të ndërpres pak. Meqënëse kemi korrur prej 25 këshilltarësh në sallë mund të hedhim në votim pikën 14 përpara se të kalojmë si asamble e përgjithshme e pronarit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po mund të hedhim në votim pikë 14 "PËR KALIMIN E PRONËSISË SË TRUALLIT PREJ 300 M2 TË DHËNË PËR NDËRTIM NGA KËSHILLI I ISH KOMUNËS DRENOVË NË EMER TË Z.NIKO TELHA NË FSHATIN MORAVË, NJËSIA ADMINISTRATIVE MORAVË".

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi



KRYETARI

ERJON NEXHIPI

